

Praktikat Qytetare të Ballkanit #7

Lidhja që Mungon? Zhvillimi dhe Funksonimi i Dialogut Civil në Ballkanin Perëndimor

Ky material është përgatitur me mbështetjen e UKaid i Departamentit Anglez për Zhvillimin Ndërkombëtar (DFID) dhe Fondit të Ballkanit për Demokraci (BTD). Pikëpamjet e shprehura në këtë studim nuk reflektojnë politikën zyrtare të Departamentit apo pikëpamjet e BTD-së.

©BCSDN

Të drejtat e autorit janë rezervuar. Pa lejen eksplicite nga ana e Rrjetit Ballkanik për Zhvillimin e Shoqërisë Civile (BCSDN), asnjë pjesë nga ky publikim nuk mund të botohet, në çfarëdo forme.

Kopje të këtij botimi mund të porositen me anë të postës ose e-mailit në këtë adresë.

Rrjeti Ballkanik për Zhvillimin e Shoqërisë Civile (BCSDN)
Qendra Maqedonase për Bashkëpunim Ndërkombëtar (MCMS) – Zyra ekzekutive
Adresa: rr. "Nikolla Parapunov" p.n., 1060 Shkup, Maqedoni
Posta elektronike: executiveoffice@balkanicsd.net
Internet faqja: www.balkanicsd.net

Botues: Rrjeti Ballkanik për Zhvillimin e Shoqërisë Civile (BCSDN)
Kryeredaktori: Tanja Hafner - Ademi
Redaktor i teksteve: Tanja Hafner – Ademi
Përkthim: Eggest Gjokuta
Lektorim: Marsida Bandilli
Dizajn dhe faqosja: Koma lab.
Shtypur: Borografika
Botuar në Maqedoni, Qershor 2010

ISBN 978-608-65119-8-2

Në bashkëpunim me:



Përmbajtja

Lista e Akronimeve	i
1. Hyrje	5
2. Konteksti i Përgjithshëm	6
3. Zhvillimi i Dialogut Civil	9
3.1. Dokumentet e Kuadrit	9
3.2. Aktet Nënligjore të Aksesit Publik tek Informacioni, Politikbërja dhe Konsultimet	12
3.3. Niveli Lokal.....	13
4. Funksionimi i Dialogut Civil	14
4.1. Mekanizmat Koordinues.....	14
4.2. Strukturat e Përbashkëta Qeveri –OSHC.....	16
4.3. Ecuria në Lidhje me Aksesin tek Informacioni, Politikbërjen dhe Konsultimet	17
4.4. Përfundimet	19
5. Integrimi në BE dhe Dialogu Civil	20
5.1. Politika e Zgjerimit.....	20
5.2. Mbështetja me Fonde nga BE-ja për Dialogun Qytetar.....	25
6. 10 Rekomandime për Dialog Civil Efikas në Ballkanin Perëndimor	28

Lista e Akronimeve

BTD	Fondi i Ballkanit për Demokraci
CARDS	Programi i Asistencës Komunitare për Ri-ndërtim, Zhvillim dhe Stabilizim
CNVOS	Qendra për Informacion, Bashkëpunim dhe Zhvillim të OJF-ve
DFID	Departamenti për Zhvillim Ndërkombëtar
FKZSHHC	Fondacioni Kombëtar për Zhvillimin e Shoqërisë Civile
GTZ	Gesellschaft für Technische Zusammenarbeit
IPA	Instrumenti i Ndhmës së Para-Aderimit
ISHC	Instrument i Shoqërisë Civile
KZSHHC	Këshilli për Zhvillimin e Shoqërisë Civile
MiM	Memorandumi i Mirëkuptimit
OSBE	Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë
OSHC	Organizatë e Shoqërisë Civile
PHARE	Polonia dhe Hungaria: Asistencë për Rindërtimin e Ekonomive të Tyre
PpPQ	Programi për Partneritet të Pjesëmarrjes Qytetare
SDC	Agjencia Zvicerane për Zhvillim
SIDA	Agjencia Suedeze për Bashkëpunim Ndërkombëtar
SUV	Strategjia për Uljen e Varfërisë
TASCO	Asistencë Teknike për Organizatat e Shoqërisë Civile
USAID	Agjencia e Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar
VA	Vend Anëtar
VAR	Vend Anëtar i Ri
ZIE	Zyra për Integrimin Evropian
ZQBmeOJF	Zyra Qeveritare për Bashkëpunim me OJF-të

1. Hyrje

Ky studim zhvillohet në vazhdimësi të përpjekjeve të BCSDN-së për t'iu ofruar aktorëve kryesorë lokalë dhe atyre ndërkombëtarë, e sidomos institucioneve të BE-së, analiza dhe rekomandime në lidhje me zhvillimin e shoqërisë civile në Ballkan duke u përqendruar tek roli i saj në kuadër të integritit në BE. Pra, ky studim bazohet në gjetjet e studimit *"The Successes and Failures of EU Pre accession Policy in the Balkans: Support to Civil Society"* të publikuar në shtator të vitit 2009 i cili për herë të parë konsideroi zhvillimin e mbështetjes të Komisionit të Bashkimit Evropian (KE) për shoqërinë civile në kontekstin e zhvillimit duke përfshirë instrumentat e kaluar (PHARE dhe CARDS) si dhe ata aktualë (IPA). Studimi theksoi mësimet e nxjerra për përmirësimin e Instrumentit të Shoqërisë Civile (ISHC) që u lançua në vitin 2008 (serisë së aktiviteteve në formë projektesh të KE-së në mbështetje të zhvillimit të shoqërisë civile dhe të dialogut qytetar) e sidomos nevojën për të përmirësuar pronësinë dhe vazhdueshmërinë e aktorëve lokalë (d.m.th. të shoqërisë civile). Ndërsa studimi i përmendur më sipër trajtoi mbështetjen prej aktorëve lokalë dhe njohjen prej Komisionit, ndryshimet e mëdha që priten nga ana e shoqërisë civile lokale mbeten ende për t'u theksuar.

Ndërsa bazohet në gjetjet dhe rekomandimet në mbështetje të zhvillimit të shoqërisë civile në vendet e Ballkanit Perëndimor, ky studim fokusohet në analizimin e situatës aktuale të zhvillimit dhe funksionimit të dialogut civil në shtatë vendet e Ballkanit Perëndimor të përfshirë në procesin e (para) aderimit.² Për më tepër, studimi nxjerr konkluzione mbi mënyrën se

si Politika e Zgjerimit mund të mbështesë më mirë përpjekjet e vazhdueshme lokale në nivel rrajonal dhe kombëtar. Rekomandimet në fjalë, u adresohen në mënyrë të barabartë të trija palëve kryesore të përfshira (KE-së, Qeverive Kombëtare, dhe Shoqërisë Civile). Eksperienca nga tre Vendet e Reja të BE-së (Bullgaria, Rumania dhe Sllovenia) përfshihet gjithashtu për të parë efektin e para dhe pas hyrjes në BE duke qenë se në shumë raste të ngjashme, dialogu civil është një prioritet i BE-së dhe si i tillë, financohet prej KE-së gjatë periudhës së aderimit. Pra, studimi në fjalë nuk është vetëm një aktivitet i veçuar por pjesë e aktiviteteve të synuara prej Programit Afatmesëm të BCSDN-së 2009-2011. Ky program ka për qëllim përmirësimin e ndikimit të OSHC-ve në zhvillimin dhe funksionimin e mekanizmave të dialogut civil në vendet e Ballkanit.

"Praktikat e mirë-strukturuara të dialogut ndërmjet institucioneve kombëtare, BE-së, institucioneve ndërkombëtare dhe OJQ-ve",³ siç mund të përkufizohet shkurtimisht dialogu i shoqërisë civile nuk është vetëm fjala "më e përmendur" aktuale në Bruksel ku shoqëria civile e Unionit po përfiton prej mundësive të reja që ofron Neni 11 i Traktatit të Lisbonës,⁴ por gjithashtu kjo vlen edhe për vendet e (para) zgjerimit në Ballkan ku rëndësia e saj është njohur prej Komisionit që në Strategjinë e tij të Zgjerimit 2007-2008. Strategjia në fjalë prezantoi zhvillimin e dialogut civil si pjesë e Kriterit Politik për aderim të Kopenhagenit. Brenda BE-së, motivi kryesor për zhvillimin e dialogut civil është të gjeturit e mënyrave të duhura për të ri-sjellë më afër politikave të BE-së qytetarët e pa-interesuar. Në Ballkan, zhvillimi i dialogut civil nxitet

1 Ky policy paper është i disponueshëm në faqen e internetit të BCSDN-së www.balkancsd.net.

2 Shqipëria, Bosnjë Hercegovina, Kroacia, Kosova, Mali i Zi dhe Serbia.

3 Fazi, Elodie & Smith, Jeremy: Dialogu civil: "Për funksionim të mirë", Kontakt Grupi për Shoqëri Civile, Bruksels: 2006, fq. 21.

4 Neni 11 i Traktatit të Lisbonës konsideron veçanërisht demokracinë me pjesëmarrje si një princip demokratik kryesor i BE-së dhe propozon mënyrat për të organizuar dialogun me "shoqatat përfaqësuese dhe shoqërinë civile".

si rrjedhojë e një procesi historik më të thellë (d.m.th. ndërtimi i bazës të kuadrit institucional demokratik çka mundëson transparencë, aftësi reaguese, efikasitet dhe përgjegjshmëri të institucioneve publike dhe përfundimin e tranzicionit nga një sistem shtetëror e shoqëror i kontrolluar prej shtetit në një shtet dhe shoqëri pjesëmarrëse.

Siç do të tregojë edhe ky studim, mekanizmat themelorë të dialogut civil janë zhvilluar në shumicën prej vendeve gjatë dekadës së fundit por megjithatë mbeten ende sfida për t'u përballur sa i përket implementimit të tij. Një fushë së cilës i duhet kushtuar vëmendje e veçantë në të ardhmen, është zhvillimi dhe implementimi i akteve specifike që mundësojnë aksesin në informacionin publik, dhe në mënyrë më të rëndësishme vendosja e standardeve minimale të konsultimit në politikë dhe politikbërje. Siç tregohet vlera e zhvillimit dhe përmirësimit të dialogut civil është më e madhe sesa thjesht funksionimi i institucioneve demokratike. Dialogu civil përbën një masë horizontale politike e cila lidhet drejtpërdrejt me reformën në administratën publike, me masat për një qeverisje më të mirë si dhe me masat kryesore të Acquis të BE-së të tilla si lufta kundër korrupsionit dhe funksionimi i shtetit të së drejtës. Për më tepër ky studim do të tregojë se nëse Komisioni dëshiron të angazhohet seriozisht, dialogu civil duhet prioritetizuar ashtu si edhe masat e tjera kryesore të Acquis dhe në të njëjtën kohë duhet të përdorë në mënyrë koherente dhe strategjike asistencën e IPA-s për financimin e masave kryesore të dialogut civil sidomos për ato që lidhen me qeveritë kombëtare dhe të cilat janë në pronësi të shoqërisë civile lokale.

Ky studim bazohet në të dhënat dhe gjetjet e *"The Successes and Failures of the EU-Pre-accession Policy in the Balkans: Support to Civil Society"* policy paper (shtator, 2009), si edhe mbi dokumenta të tjera të BCSDN, sid-

omos *"Balkan Civil Practice #5: Guide to Civil Dialogue in the Western Balkans"* (dhjetor 2007); dhe *"Progress Report 2009: Towards a Civil Society Development and Civil Society Dialogue Acquis? Background analysis"* (Tetor, 2009). Ai gjithashtu bazohet mbi të dhëna prej studimeve të fundit mbi gjendjen e shoqërisë civile në Ballkan duke përfshirë *"CIVICUS Civil Society Index Reports"* (2005-2006), *"TACSO Need Assessment Reports"* (2009) dhe *"ECAS Country Reports"* (2009). Megjithatë, më së shumti të dhënat më të fundit dhe analiza bazohen në të dhënat e marra nëpërmjet një pyetësori të unifikuar prej anëtarëve dhe partnerëve të BCSDN, më së pari prej burimesh dytësore ose studimesh të zhvilluara për nevojat e tyre, çka bën që ky studim politik të përfaqësojë një bashkëpunim të OSHC-ve lokale, sidomos të anëtarëve e partnerëve të BCSDN. Së fundmi, të dhënat e plota të përdorura për këtë studim janë publikuar si pjesë e bazës së parë të të dhënave të dialogut civil të BCSDN-së.⁵

2. Konteksti i Përgjithshëm

Të gjitha vendet që janë subjekt i kësaj analize kanë një regullore ligjore të qartë që thekson **lirinë për të krijuar shoqata**. Të gjithë kanë adoptuar ligje për shoqatat (ose për shoqatat dhe fondacionet). Ajo që është specifike për të gjitha ligjet, në veçanti me ndryshimet e tyre të fundit, është se ato janë shumë më tepër progresive dhe më në përputhje me standardet, praktikat më të mirë dhe rekomandimet Evropiane. Përsëmbull, Ligji i ri Mbi Shoqatat në Serbi i adoptuar në 22 korrik të vitit 2009 lejon të drejtën për të vepruar për organizatat informale ose të pa-regjistruara dhe ul nga 10 në 3 numrin e anëtarëve themelues që nevojiten për themelimin e një organizate. Edhe pse jo në mënyrë të qartë, ligji

⁵ E disponueshme në <http://www.balkancsd.net>.

gjithashtu përfshin termat për financimin nga buxheti kombëtar. Në Maqedoni, Ligji i Ri mbi Shoqatat dhe Fondacionet, i miratuar nga Parlamenti më 12 prill të vitit 2010, shtrin lirinë për të krijuar shoqata edhe tek personat e huaj dhe tek minorenët, duke lejuar kështu funksionimin e shoqatave jo dhe informale, ul koston administrative për regjistrimin, përmirëson masat për mirëqeverisje në organizata dhe ngre transparencën. Në këtë fushë, vendet e Ballkanit Perëndimor nuk mbesin mbrapa vendeve të tjera fqinje të BE-së ose VA-ve të tjerë në përgjithësi.

Të gjithë vendet e rajonit, lejojnë organizatat që të gjenerojnë të ardhura që përdoren për përmbushjen e qëllimeve të tyre përcaktuar nga statutet përkatëse. Mundësia që organizatat të gjenerojnë të ardhura është shumë e rëndësishme për qëndrueshmërinë e shoqërisë civile. Edhe pse të ardhurat nga aktivitetet ekonomike në këto vende aktualisht nuk janë në nivelin e vendeve të zhvilluara të Perëndimit, perspektiva, me tërheqjen e donatorëve të huaj dhe mungesën e burimeve të brendshme, është shumë e rëndësishme për ta. Më konkretisht, shumica e organizatave, përveç kontributit të tyre për përfitim publik në komunitet, gjithashtu lehtësojnë qëndrueshmërinë e tyre nëpërmjet ofrimit të shërbimeve kryesisht për aktivitete sociale. Këtu bën përjashtim Sllovenia, ku 47,4% e të ardhurave të shoqatave gjenerohen prej **aktiviteve ekonomike**.

Lidhur me përjashtime të tjera nga taksat, situata me disa përjashtime është e njejta kudo. Më së shumti, edhe kur ka përjashtime nga taksat, organizatat nuk kanë dijeni mbi mundësitë që ato mund të përdorin ose këto mundësi janë të komplikuara kështuqë ka pak interes për të përfituar prej tyre.

Lidhur me **statusin e interesit publik**, rregullat ligjore që rregullojnë veçanërisht këtë fushë ekzistojnë në Bosnjë dhe

Hercegovinë, Kosovë dhe Maqedoni. Në vende të tjera statusi i interesit publik lidhet me fusha konkrete dhe përkatësisht me organizatat humanitare (rasti i Kroacisë) ose lidhet vetëm me programet e interesit publik dhe jo me gjithë organizatën (si në rastin e Serbisë). Statusi i organizatave të interesit publik parashikohet në ligjet e Sllovenisë, Rumanisë dhe Bullgarisë. Megjithatë, në Rumani dhe Bullgari organizatat janë ankuar për implementimin problematik të këtij statusi.

Kroacia është një vend që shërben si një shëmbull i një sistemi të zhvilluar të **financimit shtetëror** në mbështetje të OJF-ve. Sistemi mbështetës zhvilluar në Kroaci është kompleks, por më e rëndësishmja për t'u theksuar është se kriteret janë të qarta, procesi është transparent dhe një shumë e madhe fondesh që vihet në dispozicion nga shteti. Sipas Raportit mbi Ndhmën Financiare të Lëvruar për Projektet dhe Programet e OSHC-ve të vitit 2009 të adoptuar prej Qeverisë më 6 maj 2010, gjatë vitit 2009 OSHC-të kanë marrë përafërsisht 73 milionë Euro. Në vende të tjera, një problem kryesor është mungesa e kriterëve të qarta dhe transparente si dhe ajo e procedurave për mbështetje. Që prej vitit të fundit (9 Mars 2009), Shqipëria ka adoptuar Ligjin mbi Organizimin dhe Funksionimin e Agjencisë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile. Agjencia e cila do të menaxhojë Fondin e Shoqërisë Civile me vlerë rreth 1 milionë Euro, ende nuk është vendosur në funksion dhe është në procesin e zgjedhjes së strukturës së parë mbikëqyrëse të saj (d.m.th. të Bordit).⁶ Nuk mund të thuhet se Bullgaria dhe Rumania kanë sisteme

⁶ Agjencia është formuar si një strukturë e pavarur afër qeverisë dhe Bordi i saj do të përfshijë një shumicë prej 5 përfaqësuesish të shoqërisë civile dhe prej 4 përfaqësuesish të administratës publike qëndrore. Anëtarët e Bordit do të shërbejnë për një mandat 4 vjeçar me mundësinë që të ri-zgjidhen dhe njëherë. Që prej hyrjes në fuqi të Ligjit në fillim të vitit 2009, Këshilli i Ministrave ka përgatitur procedurën për nominimin e anëtareve të Bordit, si dhe ka vendosur kuadrin e plotë rregullator dhe implementues të nevojshëm për funksionimin e Agjencisë.

të zhvilluara mirë mbështetjeje shtetërore përsa i përket procedurave dhe ndarjes së fondeve. Për shembull në Rumani kjo mbështetje është ulur gjatë viteve të fundit. Burime domethënëse mbështetjeje përbëjnë gjithashtu ato që vijnë nga lojërat e fatit dhe lojërat zbavitëse. Megjithatë, përveç Kroacisë dhe pjesërisht Malit të Zi, sistemi në vendet e tjera nuk është i përshtatur me nevojat (p.sh. Maqedonia, Serbia dhe gjithashtu Sllovenia). Në Bullgari dhe Rumani nuk ka një fond llotarie special që mbështet aktivitetet e OSHC-ve.

Sërisht, përveç Kroacisë ku shteti mbështet në mënyrë të dukshme sektorin e shoqërisë civile, organizatat në vende të tjera më së shumti janë të varura **nga donatorët e huaj**. Në rajon, mbështetja nga programet e zhvillimit të Evropës Perëndimore dhe SHBA-ve ndodh kryesisht nëpërmjet organizatave si USAID, SDC, SIDA të cilat sëbashku me disa organizata të tjera duket të jenë kryesoret në këtë drejtim. Megjithatë, gjatë viteve të fundit, fondet e KE-së që jepen nëpërmjet programeve të ndryshme rajonale dhe atyre që konceptohen për secilin vend kanë marrë vendin e parë në udhëheqjen e mbështetjes së huaj (ndërkombëtare). Dobësia më e përgjithshme e OSHC-ve është kapaciteti i pa-mjaftueshëm dhe përgatitshmëria e tyre e pjesëshme për t'ju përgjigjur kërkesave administrative gjatë fazës së aplikimit si dhe gjatë asaj të implementimit të projekteve që mbështeten prej programeve të KE-së. Nuk mund të thuhet se në Bullgari, Rumani ose Slloveni mbështetja për shoqërinë civile ishte ose është dominante, dhe pse në Bullgari vërehet një vartësi prej financimit prej shtetit (fonde të cilat janë pjesërisht të BE-së).⁷

Donacionet e kompanive dhe individëve janë prezente gjithashtu në të gjithë vendet. Megjithatë, qëllimi i fondeve dhe numri i

kompanive dhe individëve që ofrojnë fonde të tilla, është rekativisht i vogël dhe këto nuk zënë një vend të dukshëm krahasuar me burimet e tjera të financimit të OSHC-ve. Ajo që është e përbashkët për të gjithë vendet janë donacionet e shpeshta të kompanive për aktivitete sportive, kulturore dhe shoqërore ndërsa individët dhurojnë më së shumti për iniciativa humanitare dhe për ato që mbrojnë grupet e marxhinalizuara (si p.sh. gratë, fëmijët, personat e sëmurë etj.). Në Rumani, situata paraqitet disi më ndryshe (Sipas Forumit Rumun të Donatorëve, në vitin 2008, donatorët privatë kryesorë ofronin mbi 31 milionë Euro për iniciativat e shoqërisë civile).

Egzistenca dhe funksionimi i **koordinimit të donatorëve** për mbështetjen e shoqërisë civile nuk vërehet në vendet në fjalë megjithëse në Kroaci Zyra Qeveritare për Bashkëpunim me OJQ-të (ZQBmeOJF) po implementon me sukses një strategji për mbështetjen e koordinimit prej burimeve qeveritare dhe atyre të tjera. Megjithatë, thuhet se të gjithë vendet nuk kanë mekanizma të veçantë për t'u konsultuar me OSHC-të kur hartojnë prioritetet ose mbështetjen ndaj aktorëve të shoqërisë civile që do të financohen. Në disa raste, planet e hartuara prej Delegacioneve të BE-së në lidhje me IPA-n përbëjnë përjashtim. Në Bullgari dhe Rumani Forumet e Donatorëve (Forumit i Donatorëve në Bullgari i formuar në vitin 2003 dhe Forumit i Donatorëve në Rumani i formuar në vitin 1999) kanë disa vite që veprojnë dhe kanë kontribuar për një përfshirje më të madhe të OSHC-ve në përcaktimin e prioritetëve financiarë dhe efektshmërinë e shoqërisë civile. Pra, sa i përket përfthimit të financimeve prej burime të tjera përveç donatorëve të huaj, vendet e Ballkanit Perëndimor nuk duket të jenë pas tre VA të BE-së me të cilët janë fqinjë (Bullgaria, Rumania, dhe Sllovenia).

⁷ CSD : "Krim pa dënim: Lutta kundër korupcionit dhe krimit të organizuar në Bullgari", 2009.

3. Zhvillimi i Dialogut Civil

Në vendet e Ballkanit Perëndimor, praktikat dhe eksperiencat e marrëdhënieve dhe bashkëpunimit ndërmjet OSHC-ve dhe institucioneve publike (sidomos me Qeveritë) egziston në nivel kombëtar në formën e përpjekjeve për të përcaktuar marrëdhëniet, kuadrin ligjor dhe bashkëpunimin ndërmje autoriteteve publike (qëndrore dhe lokale) dhe OSHC-ve kryesisht në formën e strategjive qeveritare ose të marrëveshjeve dypalëshe për bashkëpunim. Siç do të tregohet më poshtë, për shkak të kuadrit socio-kulturor dhe të historisë, përqasjet institucionale dhe ligjore (strategjitë, marrëveshjet etj.) kanë qenë format më të favorizuara dhe më të përdorura.

3.1. Dokumentet e Kuadrit

Kuadri i parë, më i kuptueshëm dhe më sistematik në rajon u përcaktua në Kroaci. Institucionalizimi i bashkëpunimit ndërmjet shoqërisë civile dhe qeverisë në Kroaci filloi me vendosjen e *Zyrës Qeveritare për Bashkëpunim me OJF-të (ZQBmeOJF)* krijuar në vitin 1998. Sistemi bazohet në tre shtylla (ZQBmeOJF, Këshilli për Zhvillimin e Shoqërisë Civile (KZSHHC) krijuar në vitin 2001, dhe Fondacioni Kombëtar për Zhvillimin e Shoqërisë Civile (FKZSHHC) krijuar në vitin 2003) u përfshi në Modelin e Ri për Zhvillimin e Shoqërisë Civile në Kroaci. Zyra e cila u prezantua si shtylla e parë synonte që të ndërtonte besim dhe të zhvillonte bashkëpunimin nëpërmjet financimit, konsultimit, arsimimit, dhe ndarjes së informacionit gjatë një kohe kur marrëdhëniet ndërmjet Qeverisë dhe shoqërisë civile mbizotëroheshin prej antagonizmit prej një kohe të konsiderueshme dhe Kroacia nga fundi mandatatit të fundit të Presidentit Franjo Tuxhman konsiderohej si një vend gjysëm

demokratik. Suksesi kryesor i modelit kroat, ishte zhvillimi *konsensual* i sistemit çka rezultoi në një aparat institucional në pronësi të përbashkët dhe i cili garanton pjesëmarrje substanciale të shoqërisë civile, sidomos në politikëbërje, dhe një kuadër të qartë instrumentesh politikë të pranuar që përcaktojnë rolin e shoqërisë civile në zhvillimin e Kroacisë si dhe përgjegjësitë e qeverisë kundrejt shoqërisë civile. Së fundmi, rëndësi të veçantë kishte implementimi i *Programit për Bashkëpunim Ndërmjet Qeverisë dhe sektori të OJF-ve* i cili u siglue në vitin 2001. Ky program formoi bazat për të gjithë dokumentet e mëvonshme që regullojnë marrëdhëniet ndërmjet qeverisë dhe shoqërisë civile dhe në të cilin Qeveria njohu rolin kryesor që ka shoqëria civile në promovimin e zhvillimit socio-ekonomik dhe në demokracinë pluraliste e me pjesëmarrje. Ky vendos një listë principesh sipas të cilave qeveria duhet të veprojë në marrëdhëniet me shoqërinë civile duke përfshirë partneritetin, transparencën, përgjegjshmërinë për përdorimin e burimeve publike, promovimin e mundësive të barabarta për të gjithë, subsidiaritetin (si bazë e partneritetit); promovimi kundër dhunës, pranimi i diversitetit dhe zhvillimi i kapitalit social. Së fundmi, në 12 korrik të vitit 2006, u miratua *Strategjia Kombëtare për Krijimin e Një Ambienti Mundësues për Shoqërinë* e cila përcakton guidat bazë për përmirësimin e sistemit ekzistues dhe për formimin e një sistemi ligjor, institucional dhe financiar për mbështetjen e zhvillimit të shoqërisë civile deri në vitin 2011.

Tre vendet e tjera që pasuan në zhvillimin e një kuadri sistematik ishin Maqedonia, Bosnjë Hercegovina dhe Mali i Zi. Ndërsa në Maqedoni dhe Mal të Zi, zgjidhja ishte që të zhvillohej një strategji për qeverinë, njëlloj si në Bosnjë Hercegovinë dhe në Kroaci, u hartua një marrëveshje dypalëshe ndërmjet Këshillit të Ministrave dhe sektorit të shoqërisë civile.

Në **Maqedoni**, në vitin 2006 dhe 2007 një Projekt i Asistencës Teknike financuar nga KE/CARDS mbështeti zhvillimin e *Strategjisë për Bashkëpunim të Qeverisë me Shoqërinë Civile 2007-2011* e cila hyri në fuqi në 23 janar të vitit 2007. Gjithashtu u vendos edhe një *Njësi pr Bashkëpunimin me OSHC-të*. Në **Bosnjë dhe Hercegovinë** Këshilli i Ministrave sëbashku me përfaqësuesit e shoqërisë civile sigloi në 7 maj të vitit 2007 *Marrëveshjen për Bashkëpunim Ndërmjet Këshillit të Ministrave të BiH dhe Sektorit Jo-Qeveritar*. Në përputhje me Marrëveshjen u krijua në tetor 2007 një *Bord i Shoqërisë Civile*, i përbërë prej përfaqësuesve të shoqërisë civile mbështetur nga 31 nën-sektorë. Në **Mal të Zi** *Strategjia për Bashkëpunim ndërmjet Qeverisë dhe OSHC-ve* u miratua në 22 janar të vitit 2009 e cila pasoi vendosjen e një *Zyre për Bashkëpunimin me OSHC-të*. Si në Kroaci dhe në ndryshim me Maqedoninë, Strategjia parashikoi gjithashtu vendosjen e një Këshilli për koordinimin e implementimit të Planit të Veprimit. Vendimi për të vendosur Këshillin u kalua vetëm në 15 prill të vitit 2010 dhe prandaj do të bëhet funksional në të ardhmen. Ndërsa në BiH dhe në Mal të Zi, iniciativa u la në pronësi të iniciativave/ rrjeteve të shoqërisë civile,⁸ në Maqedoni forca shtytëse kryesore e procesit ishte mbështetja prej KE-së.

Pjesa tjetër e vendeve të rrajonit (**Shqipëria, Kosova dhe Serbia**) kanë zhvilluar elemente të kuadreve të tilla ose përpjekje për to por **ende nuk kanë një kuadër sistematik të dialogut civil**. Analizat tregojnë një **kombinim të përqasjeve (ps**

8 Në Bosnjë Hercegovinë kjo ishte koalicioni "Të Punojmë dhe t'ja dalim Sëbashku" vendosur në vitin 2001 i cili mblodhi sëbashku 300 OSHC prej të gjithë etnive dhe punoi për zhvillimin e dokumenteve strategjike për bashkëpunim me institucionet publike dhe zhvillimin e shoqërisë civile. Në Mal të Zi, koalicioni "Duke Bashkëpunuar Drejt Qëllimit" i udhëhequr prej Qendrës për Zhvillim të OJF-ve (CRNVO) u krijua me pjesëmarrje e 260 OSHC-ve duke synuar vendosjen e një dialogu dhe bashkëpunimi më të madh me Qeverinë.

strategji, marrëveshje bilaterale) por në të gjitha rastet **pronësia e theksuar e shoqërisë civile lokale** ka përbërë deri tani forcën kryesore për shtyrjen përpara të përpjekjeve.

Në **Kosovë**, në vitin 2008 u siglua një Memorandum Mirëkuptimi (MiM) ndërmjet platformës së shoqërisë civile CivilKos dhe Kryeministrit. Ai vendosi principet për bashkëpunim dhe hartoi një strategji qeveritare kundrejt zhvillimit të shoqërisë civile, ndërtimit të partneritetit në zhvillimin politik dhe sigurimit të dialogut efektiv ndërmjet të dy sektorëve. Ndërsa njëri prej objektivave ishte që secila ministri të siglonte një MiM të njëjtë me OSHC-të që ata punojnë, deri sot, vetëm Ministria e Mjedisit ka sigluar një MiM me shoqatat ambientaliste në vitin 2008. Në **Shqipëri**, *Karta e Shoqërisë Civile Shqiptare* u lançua vetëm së fundmi në dhjetor të vitit 2009. Kjo kartë u hartua nga një task forcë që përbëhej prej anëtarëve të Shoqërisë Civile dhe prej Qeverisë dhe është konsultuar nëpër të gjithë vendin. Ndërsa procesi, si në shumë vende të tjera është gjerësisht në pronësi të shoqërisë civile, mbështetja e donatorëve si GTZ dhe OSBE duket se janë instrumentale në këtë përpjekje. Së fundmi po jo më pak e rëndësishmja në **Serbi** pas përpjekjesh të konsiderueshme lobuese nga ana e shoqërisë civile, Qeveria ka adoptuar *Vendimin mbi Vendosjen e një Zyre Qeveritare për Bashkëpunimin me Shoqërinë Civile*, e cila do të punojë gjithashtu për hartimin e strategjisë kombëtare për zhvillimin e shoqërisë civile. Përveç kësaj, Serbia ka shembuj marrëveshjesh sektoriale për bashkëpunim dhe mekanizmash të tilla si *Memorandumi i Bashkëpunimit në Procesin e Integritimit Evropian* që u siglua në 12 korrik të vitit 2005 me Zyrën për Integritim Evropian (ZIE) dhe Zyrën e *Strategjisë për Uljen e Varfërisë (SPUV)* të Zëvendëskryeministrit i cili nëpërmjet Koordinatorëve Lokalë punon në bashkëpunim me OSHC-të Lokale për

adresimin e çështjeve të uljes së varfërisë dhe përfshirjes sociale.

Në krahasim me rajonin, Bullgaria, Rumania dhe Sllovenia, tre vende fqinje anëtare të BE-së, kanë në shumicën e rasteve një zhvillim më pak sistematik të kuadrit për dialog civil. Në Bullgari, nuk ka rregulla dhe procedura uniforme, mungojnë mekanizmat koordinatorë dhe dhe single-point entry për të lehtësuar marrëdhëniet ndërmjet shoqërisë civile dhe qeverisë. Në Rumani, Ministria e Integritimit Evropian, kontrakttoi në vitin 2003 një kompani të huaj nën programin PHARE për zhvillimin e një strategjie për shoqërinë civile. Dokumenti ishte shumë i varfër sa i përket pëmbajtjes dhe metodologjisë dhe OSHC-të ishin tejet kritike kundrejt kësaj strategjie. Zyrtari që merrej me strategjinë në Ministri dha dorëheqjen dhe strategjia nuk u implementua kurrë. Megjithatë, mekanizmat e koordinimit për marrëdhëniet edhe pse u ri-emëruan dhe u zhvendosën nga ana hierarkike, kanë ekzistuar vazhdimisht në Qeveri në Zyrën e Kryeministrit që prej vitit 1993. Aktualisht, *Njësia për Strategjitë e Qeverisë* që ka për detyrë të japë informacion mbi aktivitetet e OSHC-ve, të mbështetë iniciativat e tyre dhe të lehtësojë konsultimet me qeverinë, ka bashkë-sponsorizuar aktivitete të OSHC-ve, ka mbështetur propozimet e OSHC-ve dhe ka shërbyer si kanal komunikimi ndërmjet OSHC-ve dhe politikbërësve. Interesante është të përmendim se një zyrë e tillë gjithashtu ekziston në Parlament (*Zyra për Informacion Publik dhe Marrëdhënie me Shoqërinë Civile në Dhomën e Deputetëve të Rumanisë* (dhoma e ulët e parlamentit). Në Slloveni, një *Strategji për Zhvillimin Sistematik të OJQ-ve* u përgatit në vitin 2003 nga Qeveria. Një Marrëveshje ndërmjet Qeverisë dhe OSHC-ve u përgatit gjithashtu por nuk u miratua kurrë prej qeverisë. Megjithatë, si në rastin e Rumanisë, një *Zyrë për OJQ-të* është krijuar si pjesë e Ministrisë së Administratës Publike si dhe Grupi i Punës Ndër Ministror për Qëndrimet për harmonizimin

e pyetjeve të hapura në fushën e bashkëpunimit ndërmjet Qeverisë dhe OSHC-ve që u krijua në Nëntor të vitit 2005 dhe ka si detyrë implementimin e Strategjisë dhe të punojë mbi Marrëveshjen e pa sigluar si dhe të zgjidhë pyetje të tjera të hapura ndërmjet Qeverisë dhe sektorit në fjalë.

Në shumicën e rasteve dokumentet në fjalë u hartuan **në bashkëpunim të ngushtë me OSHC-të ose edhe u bashkë-hartuan prej OSHC-ve dhe përfaqësuesve të qeverisë**, brenda grupit të punës ose task forcave. Grupi i punës ndër-ministror **Malazez**, në bashkëpunim të ngushtë dhe shpesh nën udhëheqjen e një koalicioni OSHC-sh, me anë të *Bashkëpunimit drejt qëllimit*, ka publikuar me sukses një *Strategji Veprimi për Bashkëpunim ndërmjet Qeverisë dhe OSHC-ve*. Karta e Shoqërisë Civile **Shqiptare** e vitit 2009 u hartua gjithashtu nga një task force formuar nga anëtarët e shoqërisë civile (dmth. Co-Plan, Partners Albania, dhe Qendra për Aleancën e Zhvillimit Gjinor) dhe nga Qeveria (përfaqësues të Këshillit të Ministrave, Ministrisë së Brendshme dhe Ministrisë së Integritimit). Në **Bosnjë Hercegovinë**, kjo i detyrohet koalicionit *Të Punojmë dhe t'ja Dalim me Sukses Sëbashku* që u lançua në vitin 2001 dhe mblodhi sëbashku 300 OSHC nga i gjithë vendi për të hartuar Marrëveshjen me anë të një serie prej 15 grupesh rajonale të referencës mbajtur gjatë vitit 2004.

Në disa raste, procesi u mbështet prej **donatorëve** në një mënyrë më të vazhdueshme çka lejoi për një proces më të *kuptueshëm dhe me përfshirës*, siç qe Karta Shqiptare e Shoqërisë Civile nëpërmjet Projektit të GTZ për Shoqërinë Civile ose Strategjia Maqedonase përgatitur me asistencën teknike të KE-së dhënë Njesisë Qeveritare për Bashkëpunim me OSHC-të. Në rastin e Maqedonisë, kjo mbështetje mundësoi eksperiencën e duhur për përgatitjen e dokumentit si dhe për lehtësimin e konsultimeve me bazë të

gjerë mbi hartimin me pjesëmarrjen e 380 OSHC-ve dhe të debateve me publike me bazë të gjerë. Procesi pjesëmarrës ishte instrumental për të dyja anët për të arritur qartësi si dhe pritshmëritë e tyre përkatëse dhe për të siguruar që prioritetet kryesore të ishin të përfshira në dokumentin final.

Pra në vendet ku procesi është më në **pronësi të vendasve** dhe ku bazohet më konkretisht në përpjekjet e shoqërisë civile lokale, kjo mund të marrë **më shumë kohë** dhe **rezultatet përfundimtare mund të jenë më pak të parashikueshme**. Pavarësisht kësaj, atje ku përpjekjet bëhen pa pronësinë lokale, dhe ku procesi zhvillohet vetëm prej ekspertëve të paguar, si p.sh. në Rumani, kuadret mund të mos hartohen fare. Zhvillimi i kuadrit të dialogut civil dhe i mekanizmave për këtë është një **proces** më së pakti me natyrë **konsensuale**, ku autoritetet publike dhe shoqëria civile bëhen sëbashku për të hartuar si partnerë të barabartë pritshmëritë e përbashkëta, përgjegjësitë dhe “rregullat e përfshirjes”. Për më tepër siç do të tregohet edhe në kapitullin tjetër, përpjekjet për zhvillimin e strategjive dhe marrëveshjeve janë prerogative për **zhvillim sistematik** të dialogut civil, por **implementimin i akteve dhe masave** që lidhen me **aksesin publik tek informacion, zhvillimin e politikave dhe standardet minimale të konsultimit** përbëjnë **çelësin kryesor** dhe **testin** e partneritetit real dhe funksional ndërmjet institucioneve publike dhe shoqërisë civile.

3.2. Aktet Nënligjore të Aksesit Publik tek Informacioni, Politikbërja dhe Konsultimet

Në disa vende si Kroacia dhe Bosnjë Hercegovina disa dokumente (nënligjore) specifike vendosin standardet minimale, ndërsa në të tjerë deri më sot egziston vetëm baza ligjore e përgjithshme për sigurimin e pjesëmarrjes qytetare në hartimin e legjislacionit në nivel shtetëror. Në Bosnjë Hercegovinë Rregullat për Konsultimet në Proceset e Hartimit Legjislativ u miratuan nga Qeveria gjatë vitit 2006. Në **Kroaci**, shtesa e fundit e mekanizmave institucionalë për përfshirjen e shoqërisë Civile është *Kodi i Konsultimeve Publike në Procedurat e Kalimit të Ligjeve dhe Akteve të Tjera miratuar në nëntor 2009* i cili do të shoqërohet prej *Guidës për Implementimin e Kodit dhe Procesin e Organizuar të për Konsultim Publik* që po hartohet aktualisht. Megjithatë, miratimi i Kodit u kritikua ashpër prej OSHC-ve sepse u krye në një sesion të mbyllur dhe sepse u ndryshua pas një inputi të madh të dhënë prej shoqërisë civile. Mesa duket, lidhja me masat anti-korrupsion për të cilat Kroacia është nën presion të fortë prej Komisionit, solli urgjencë dhe mungesën e konsultimeve mbi adoptimin e Kodit.

Në vende të tjera, çështja e aksesit, pjesëmarrjes dhe standardeve të konsultimit është aktualisht pa bazën ligjore përkatëse d.m.th. ekziston bazuar mbi ligje dhe akte nënligjore të përgjithshme. Në **Shqipëri**, *Ligji për Akses në Dokumentet Zyrtare* përbën bazën ligjore në këtë drejtim. Në **Maqedoni**, pjesëmarrja garantohet prej *Kushtetutës, Ligjit ligjit dhe rregullores së qeverisë, rregullores së parlamentit, mbi Qeverinë, Ligjit mbi Parlamentin, Ligjit mbi Vetëqeverisjen Lokale* si dhe prej *Strategjisë për Bashkëpunim të Qeverisë me Shoqërinë Civile* e cila synon “Pjesëmarrje të Sektorit Civil në procesin Vendimarrës.”. Në

Kosovë⁹ kjo bazohet tek *Ligji, no ksesin tek Dokumentat Zyrtarë Rregullat Procedurale të Qeverisë* dhe tek *Ligji mbi Vetëqeverisjen Lokale*. Në **Serbi**, *Rregullat Procedurale të Qeverisë* gjykohet se nuk përbëjnë një instrument efikas për pjesëmarrjen e OSHC-ve në procesin e hartimit të ligjeve dhe instrumenteve të tjera të politikave publike, dhe prandaj pjesëmarrja e OSHC-ve bazohet më së shumti mbi iniciativën dhe vetë-organizimin e sektorit. Në të njëjtën mënyrë, *Ligji mbi Parlamentin* që u miratua së fundmi nuk përcakton detyrimet për transparencë publike mbi punën e komiteteve parlamentare, duke u lejuar atyre të drejtën përjashtuese për vendosjen mbi përfshirjen ose jo të publikut. Megjithatë, një institut i dëgjimit publik është prezantuar së fundmi i cili megjithatë ka një përdorim të rradhë.

Nga të tre vendet e Ballkanit që janë VA të BE-së, vetëm Sllovenia ka bazë ligjore specifike. Në **Bullgari**, legjislacioni i gjerë detyruet mbi konsultimin përfshin *Ligjin për Aktet Ligjore*, konsultimet ndërmjet Këshillit Ekonomik dhe Social (i cili megjithatë nuk është i hapur për gjithë OSHC-të) si edhe principin detyruet të partneritetit në Rregulloret e Fondeve Strukturore të BE-së (i cili megjithatë ende nuk *zbatohet gjerësisht* dhe me efikasitet të plotë). Amendamentet e Ligjit për Aktet Ligjore janë iniciativë e një sërë OSHC-sh dhe propozojnë një kuadër të qartë rregullash për konsultim me palët e interesuar gjatë hartimit dhe shtimin e impaktit të vlerësimit. Së fundmi, Qendra Bullgare për Ligjin e OJF-ve e Forumit për Pjesëmarrje Qytetare ka hartuar *Rregulla për Konsultimin Publik* për të lehtësuar nivelin e marrëdhënieve OSHC-shtet. Sipas legjislacionit **Rumun**, OSHC-të janë të titulluara që t'i propozojnë ndryshime

⁹ Përfshirja është mbështetur edhe prej Zyrës për Qeverisje të Mirë të Zyrës së Kryeministrit e cila ka mandatin që të sigurojë implementimin e principeve të mirëqeverisjes në qeveri edhe nëpërmjet përfshirjes së shoqërisë civile në aktivitetet e Qeverisë.

Qeverisë dhe Parlamentit. Një rast i tillë u paraqit edhe në vitin 2000 kur u hartua një ligj mbi shoqatat dhe fondacionet. Në **Slloveni**, *Procedura e Rregullave të Qeverisë* miratuar në Mars të vitit 2006, përmban obligimet për konsultim publik përpara miratimit të një rregulloreje ose dokumenti strategjik dhe *Rezoluta e Akteve Normative* e nëntorit të vitit 2009 garanton standardet minimale për konsultimin me publikun, duke përfshirë dhe kohën minimale të zgjatjes së Konsultimit (30 ditë).

Pra, ndërsa këta mekanizma specifike janë shumë më të pa zhvilluar nëpër rrajon duket se në shumë raste, strategjitë dhe marrëveshjet bilaterale janë në konkurrencë me aktorë të tjerë shumë më të gjerë (sidomos me Ligjin mbi Rregullat e Procedurës së Qeverisë dhe Parlamentit) si një **mënyrë për të hapur derën për shoqërinë civile që ajo të testojë angazhimin e institucioneve publike për partneritet real** me këtë sektor **nëpërmjet zhvillimit të akteve nënligjore specifike që përfshijnë të drejtën për informacion si edhe standardet minimale të konsultimit në politikbërje.**

3.3. Niveli Lokal

Në nivelin lokal, dialogu ndërmjet OSHC-ve dhe qeverisjes lokal gjithashtu bazohet në rregullat e përfshirjes me OSHC-të si edhe mbi marrëveshje të veçanta dhe mbi strukturat për bashkëpunim. **Ligjet mbi Bashkëqeverisjen Vendore** zakonisht përmbajnë dispozita për OSHC-të dhe përfshirjen qytetare. Për shembull në **Shqipëri**, *Ligji mbi Veprimtarinë e Qeverisjes Lokale* përfshin pjesëmarrjen në nivel lokal, në **Kosovë** *Ligji mbi Vetëqeverisjen Lokale* *njej* të drejtën e qytetarëve të bashkisë dhe u garanton atyre të drejtën për peticion, iniciativa qytetare dhe referendume vendore. Në **Mal të Zi**, *Ligji për Vetëqeverisjen Vendore*, parashikon se administrata vendore bashkëpunon gjerësisht me shoqërinë civile

lokale dhe promovon rolin e saj në procesin vendimarrës.¹⁰

Përveç bazave ligjore për bashkëpunim disa bashki kanë vendosur gjithashtu **struktura për bashkëpunim me OSHC-të** të tilla si bordet këshilluese (vendosur në thuajse gjysmën e bashkive Kroate) ose si personat e kontaktit në qeverisjet bashkiake (që veprojnë në 52% të bashkive Maqedonase) dhe marrëveshje të zyrtarizuara mbi bashkëpunimin ndërmjet qeverisjes vendore dhe OSHC-ve (18.1% në Kroaci dhe 22% në Maqedoni). Në **Maqedoni** egzistojnë disa shembuj të mirë të politikave dhe dokumenteve strategjike që lidhen me bashkëpunimin me shoqërinë civile të cilat janë në fuqi një bashkitë e mëdha urbane si në qytetin e Shkupit (*Strategjia për Bashkëpunimin me OSHC-të*) dhe në Bashkinë e Karposit (*Plan veprimi Strategjik për Bashkëpunim*). Këto bashki gjithashtu kanë njësi ose persona përgjegjës për bashkëpunimin me OSHC-të. Stukturat e bashkëpunimit që lidhen me çështje të fushave specifike janë në fuqi në disa vende. Në **Serbi** përshembull, Komiteti Bashkiak i Koordinimit për Politikën Sociale (KBBPS), Këshilli për Çështje që Lidhen me Personat me Aftësi të Kufizuar në Qytetin e Kragujevacit dhe Zyrat e Rinisë që janë vendosur në rreth tetëdhjetë bashki ose rajone në Serbi me mbështetjen e Ministrisë së Rinisë dhe Sporteve janë disa prej strukturave në fjalë. Në përgjithësi, **mekanizmat dhe praktika në nivel lokal duket të jetë e ulët**, por praktikat aktuale kanë treguar **potencialin për zhvillim dhe nevojën** për përfshirjen e OSHC-ve

10 Siç theksohet prej Malazezes CRNVO, pjesë e marrja substanciale e OSHC-ve në strategjinë e zhvillimit lokal dhe të politikbërjes është ende një gjë e rrallë dhe edhe të drejtat që përcaktohen nga ligji nuk implementohet tërësisht -përshembull insitucioni i të ashtuquajturës "karrige bosh" ose të "lirë" i cili do të lejonte OSHC-të lokale për të marrë pjesë në sesione plenare të asambleve lokale (pa të drejtë vote) deri më sot është implementuar në mënyrë të kënaqshme dhe sipas guidave dhe rregullave vetëm në një nga 21 bashkitë e Malit të Zi (Tivat).

dhe qytetarëve në proceset politike dhe vendimarrëse të përditshme në nivelin lokal.

4. Funksionimi i Dialogut Civil

4.1. Mekanizmat Koordinues

Në vendet ku dokumentet e kuadrit për bashkëpunim ndërmjet OSHC-ve dhe autoriteteve publike janë zhvilluar, këto **vendosin një bazë të qartë për marrëdhënien dhe me anë të kësaj lehtësojnë dialogun në vazhdim dhe mirëkuptimin reciprok ndërmjet OSHC-ve dhe autoriteteve publike**. Në mënyrë që të avancohet implementimi i këtyre strategjive, shumë prej tyre shoqërohen nga **plane veprimi për implementimin e tyre** (p.sh. Mali i Zi, Maqedonia dhe Kroacia). Megjithatë, përveç Kroacisë, dokumentet duket se kanë qenë shumë ambicioze në vendosjen e hapit të implementimit sidomos në zona kritike si në përgjegjshmërinë dhe transparencën e mbështetjes me fonde shtetërore të shoqërisë civile dhe në masat zhvilluese për përfshirjen e OSHC-ve në procesin politikbërës.

Institucionet kryesore në implementim, d.m.th. mekanizmat koordinues, egzistojnë në **nivele dhe pozicione hierarkike të ndryshme** dhe kanë **detyra të ndryshme** për koordinimin dhe influencimin e politikbërjes. Shembuj ku ka një mungesë të dukshme të strukturave në institucionet qeveritare, si p.sh. në Shqipëri ku nuk ka një departament specifik që merret marrëdhëniet me shoqërinë civile, janë të rralla. Shumica e vendeve kanë:

- **Zyra qeveritare** të veçanta për **bashkëpunimin me OSHC-të** (p.sh. në Kroaci, Maqedoni, Mal të Zi), të cilat janë përgjegjëse për forcimin e bashkëpunimit me OSHC-të dhe me autoritetet e tjera publike;

- **Zyrtarë kontakti** në ministri dhe në institucione të tjera të qeverisë qendrore (zakonisht nën koordinimin e Zyës Qendrore kur ajo ekziston);
- **Struktura të përbashkëta** të tjera (p.sh. këshille, komitetete me shumë-aktorë kyç, grupe pune, këshilla ekspertësh dhe struktura të tjera këshillimore) për bashkëpunim ndërmjet OSHC-ve dhe autoriteteve publike (brenda Qeverisë, Ministrive dhe Parlamentit) me qëllim për Fshirjen e OSHC-ve në zhvillimin, implementimin dhe monitorimin e proceseve dhe programeve.

Zyra e Qeverisë për Bashkëpunim me OJQ-të (ZQBmeOJQ-të) e **Kroacisë**, formuar në vitin 1998, shihet si një model për shumë prej rrajoneve që ende përpiqen për një struktura bashkëpunimi më të zhvilluar. Sipas *Rregullores për ZQBmeOJQ*, zyra ka si detyrë të koordinojë punën e ministrive, zyrave qendrore të shtetit, zyrave të qeverisë Kroate dhe organizatave administrative shtetërore si dhe strukturave administrative në nivel lokal lidhur me monitorimin dhe përmirësimin e bashkëpunimit dhe monitorimit me sektorin e shoqërisë civile.

Në **Maqedoni**, vetëm një zyë përgjegjëse pë lehtësimin e bashkëpunimit qeveritar me shoqërinë civile, *Njësia për Bashkëpunim me OJQ-të*. Kjo njësi u formua në Nëntor të vitit 2004 si pjesë e Sektorit për Analiza dhe Koordinimin e Politikave të Sekretariatit të Përgjithshëm të Qeverisë dhe filloi të jetë aktive në mars të vitit 2006. Në teori Njësia është përgjegjëse për koordinimin e personave të kontaktit për shoqërinë civile në secilën ministri.

Ashtu si në Maqedoni, në **Mal të Zi**, bashkëpunimi ndërmjet qeverisë dhe shoqërisë civile bazohet në një *Zyrë Qeveritare për Bashkëpunim me OSHC-të* dhe në një rrjet zyrtarësh përgjegjës në ministritë dhe në institucionet e tjera

qëndrore të Qeverisë. Zyra për Bashkëpunim u krijua vetëm në vitin 2007 dhe procesi për vendosjen e *Këshillit për Bashkëpunim ndërmjet Qeverisë dhe OSHC-ve* filloi në pranverë të vitit 2010, me përfshirjen e shoqërisë civile e cila u konsultua për Vendimin për Vendosjen e Këshillit.

Më së fundmi, **Serbia**, pas përpjekjesh lobuese të konsiderueshme prej shoqërisë civile, është gjithashtu drej vendosjes së *Zyës Qeveritare për Bashkëpunim me Shoqërinë Civile* e cila gjithashtu do të punojë për hartimin e Strategjisë Ndërkombëtare për Zhvillimin e OSHC-ve. Zyra, krijuar në 15 prill të vitit 2010, do të jetë drejtpërdrejt në vartësi të Kryeministrit, njësoj si në rastin e Kroacisë.

Në **Kosovë**, *Departamenti për Regjistrimin dhe Ndihmesën e OJQ-ve* është një njësi speciale qeveritare brenda Ministrisë të Administratës Publike e cila administron politikën që lidhen me regjistrimin dhe bashkëpunimin me OJQ-të por, ndryshe nga shembujt e mësipërm, atje nuk ka "pika kontakti" të tjera në ndonjë prej Ministrive.

Në tre shtetet e Ballkanit që janë VAR situata është e ndryshme por në asnjë rast më mirë sesa në vendet e (para) aderimit. Në **Bullgari**, nuk ka mekanizma koordinativë. Në **Rumani**, Zyra është vendosur në Zyrën e Kryeministrit që prej vitit 1993 por ka ndryshuar shpesh nivelin dhe detyrat. Aktualisht ajo është *Njësia për Strategji Qeveritare*. Shefi i Njesisë raporton tek një prej këshilltarëve të shtetit të Kryeministrit. Në **Slloveni**, detyra për koordinimin e OSHC-ve është rritur në nivel me krijimin e zyrës për OJQ-të në Minsitrinë e Administratës Publike e cila ka si kompetencë adresimin e çështjeve horizontale të OSHC-ve. Sekretari i Shtetit i Ministrisë së Administratës Publike është gjithashtu në krye të Grupit Ndër-Ministror të përbërë prej anëtarëve të të gjithë Ministrive të Linjës.

4.2. Strukturat e Përbashkëta Qeveri –OSHC

Përveç zyrave për bashkëpunim janë vendosur një sërë strukturash të **përbashkëta** ose *ad hoc* në lidhje me disa detyra specifike mbi formulimin e strategjive ose si trupa këshillues permanentë për çuarjen përpara të dialogut ndërmjet OSHC-ve dhe autoriteteve publike. **Kur egzistojnë, struktura të tilla duket se kanë një rrol kryesor për pasjen e vendimeve të pronësisë së përbashkët dhe konsensuale për çështjet lidhur me zhvillimin e shoqërisë civile dhe me proceset e gjera shoqërore.**

Këshill për Zhvillimin e Shoqërisë Civile (KpZSHHC) në Kroaci i cili u formua si një njësi këshilluese qeveritare në vitin 2002 përbëhet prej dhjetë anëtarësh të vendosur nga strukturat administrative shtetërore, 10 përfaqësuesish të përzgjedhur të shoqërisë civile si dhe 3 ekspertësh të shoqërisë civile. Këshilli është në radhë të parë përgjegjës për zhvillimin dhe implementimin e Strategjisë Qeveritare në Mbështetje të Shoqërisë Civile, duke vepruar si një këshilltar ekspert për qeverinë, por ai ka gjithashtu edhe një rrol kryesor në monitorimin e mbështetjes monetare të dhënë nga shteti për financimin e aktiviteteve të OSHC-ve. KpZSHHC-ja është mekanizmi institucional më i rëndësishëm për bashkëpunimin qeveri-shoqëri civile duke qenë se ai përbën një forum për një dialog të formalizuar dhe direkt ndërmjet përfaqësuesve të shoqatave të qytetarëve dhe administratës publike në çështje që lidhen drjetpëdrejt me zhvillimin e shoqërisë civile. Me një mandat të rishikuar, që prej vitit 2010, ai do të përfshijë gjithashtu përfaqësues të fondacioneve dhe sindikatave në mënyrë që të ketë më shumë drejtësi në emërtimin e tij dhe për të diversifikuar organizimin e shoqërisë civile. Bazuar mbi Marrëveshjen për Bashkëpunim ndërmjet Këshillit të Ministrave të Bosnjë

Hercegovinës dhe Sektorit jo Qeveritar miratuar në vitin 2007, në **Bosnjë Hercegovinë** u krijua një *Bord i Shoqërisë Civile* si një struktura konstitutive e shoqërisë civile. Bordi konsiston prej aktivistësh të sektorit të OSHC-ve, me delegatë që vijnë prej 31 sektorësh të ndryshëm institucionesh të CSO-ve. Bordi ndodhet në pikën fillestare të veprimtarisë së tij dhe në proces konsolidimi. Ai do të shërbejë si një njësi këshillimore në bashkëpunim me organizatat e shoqërisë civile, donatorët ndërkombëtarë, qytetarët dhe median.

Në **Serbi**, në vitin 2007 u formua *Këshilli i Presidentit të Republikës për Marrëdhëniet me Shoqërinë Civile* (ose *Këshilli i Shoqërisë Civile*) që përfshin disa përfaqësi OSHC-sh dhe zyrtarisht ka si detyrë lehtësimin e komunikimit OSHC-Qeveri. Megjithatë, kjo njësi është pak a shumë një trup këshillimor *ad hoc* i cili takohet në mënyrë jo-frekuente dhe pa terma reference të qartë dhe të parashtruar.

Së fundmi, në **Mal të Zi**, është marrë një vendim në 15 prill të vitit 2010 sipas Strategjisë për Bashkëpunim me OSHC-të, për krijimin e *Këshillit për Bashkëpunim ndërmjet Qeverisë dhe OSHC-ve*.

Nga të tre vendet e Ballkanit që janë VA, vetëm në **Rumani** është identifikuar një strukturë e tillë e cila nuk është më e hershme sesa ato në vende të tjera të Ballkanit Perëndimor. Në vitin 2006, Kryeministri vendosi nën vartësinë e Zyrës së tij një *Këshill për Dialog me Fondacionet dhe Shoqatat*. Rreth 50 përfaqësues OSHC-sh u ftuan të merrnin pjesë në këtë strukturë. Aktualisht Kryeministri u ka kërkuar OSHC-ve të paraqitin propozime për të bërë këtë strukturë më aktive dhe për t'u fokusuar mbi strategjitë për përmirësimin e dialogut dhe konsultimeve ndërmjet OSHC-ve dhe Qeverisë. Në gusht të vitit 2010, anëtarë të rinj do të vendosen në këtë strukturë me një mandat 5 vjeçar dhe me një sërë objektivash

që duhen arritur nga bashkëpunimi ndërmjet dy palëve.

Edhe pse janë zakonisht të vendosura brenda Qeverisë, në rrajon ekzistojnë edhe disa instanca strukturash për bashkëpunim brenda **Parlamentit**. Zyra për *Bashkëpunim Ndërmjet OSHC-ve dhe Parlamentit* u krijua në vitin 2004 me siglimin e *Memorandumit për Bashkëpunim* ndërmjet Shoqatave të Qytetarëve, MOST dhe Parlamentit të Republikës së **Maqedonisë**. Qëllimet kryesore të kësaj zyre janë: institucionalizimi i bashkëpunimit ndërmjet organizatave të shoqërisë civile dhe Parlamentit, lidhja e qytetarëve me trupat legjislativ, dhënia e informacionit relevant dhe të dhënave që duhen për intensifikimin e dialogut ndërmjet Parlamentit dhe organizatave të shoqërisë civile duke përfshirë të gjithë kanalet e komunikimit. Po kështu ndodh edhe në Rumani ku ekziston *Zyra për Informacionin Publik dhe Marrëdhëniet me Shoqërinë Civile ne Dhomën e Deputetëve të Rumanisë* (Dhoma e ulët e Parlamentit). Zyra u krijua me fondet e BE-së nën programin PHARE për shoqërinë civile (1994 – 1996) me një fond mbështetës prej rreth 200,000 Euro. Zyra gjithashtu lidhet me një mekanizëm për financimin e OSHC-ve për të marrë pjesë në procesin legjislativ (d.m.th. 200,000 Euro në vit me anë të granteve prej 10,000 Euro). Zyra gjykohet se është një mbështetje efikase për bashkëpunim me Parlamentin dhe OSHC-të kanë luftuar kundër iniciativave për shkrimin e saj në kuadër të uljes së kostove.

4.3. Ecuria në Lidhje me Aksesin tek Informacioni, Politikbërjen dhe Konsultimet

Siç u theksua dhe në Kapitullin 3.2., akte të veçanta (nënligjore) ekzistojnë në disa vende lidhur me vendosjen e standardeve minimale të aksesit në informacionin publik si dhe për pjesëmarrjen e OSHC-ve në politikbërje. Megjithatë, kur shikohet praktika, një nga problemet kryesore është se **rregullat**

janë shpesh të pamajftueshëm ose se ato janë të implementuara në nivele të ulëta.

Në **Serbi**, *Rregullat Procedurale të Qeverisë* gjykohet se nuk janë një mekanizëm efikas për pjesëmarrjen e qytetarëve dhe OSHC-ve në procesin e hartimit të ligjeve dhe të instrumenteve të tjera të politikës publike dhe si rrjedhojë pjesëmarrja e qytetarëve dhe e OSHC-ve bazohet më tepër mbi iniciativë dhe vetë organizim sesa mbi ligje të shkruara. Në **Bosnjë Hercegovinë** prerogativat e *Regullave mbi Konsultimet dhe Proceset e Hartimit të Ligjit* janë aplikuar vetëm në raste të rralla¹¹ dhe shpesh vetëm si rezultat i nevojës për të përmbushur kushtet për financim prej një iniciative që mbështetet nga ndërkombëtarët. Në **Shqipëri**, vetëm një numër i vogël ministrish kanë ndërmarrë masa për implementimin e prerogativave të *Ligjit mbi Aksesin tek Dokumentat Zyrtare* dhe për implementimin e *Urdhëresës së Këshillit të Ministrave për vendosjen e Zyrave të Informacionit Publik në Ministrinë e Linjës*, kështuqë në disa raste edhe para-kushtet bazë për pjesëmarrje si p.sh. aksesin në informacion nuk përmbushen. Në **Maqedoni**, *Strategjia e Qeverisë* flet për nevojën që të gjithë Ministrinë të publikojnë ndryshimet e reja politike të propozuara në internet por deri tani është bërë pak për krijimin e një partneriteti real (fizik) ndërmjet të dy palëve.

Në disa raste prerogativat janë të paqarta ose mund të **dëmtojnë thelbin e pjesëmarrjes në politikbërje dhe vendimarrje**. Në **Maqedoni** *Ligji për Lobimin*, miratuar në gusht të vitit 2008,

11 Një vlerësim i fundit i implementimit të Rregullave nga organizatat jo-qeveritare, ACIPS (Shoqata e të Diplomuarve në Qendrën për Studime Pasuniversitare Ndër Disiplinore) vërejtë se këto masa janë ndërmarrë vetëm në një nga 9 ministrinë e shtetit dmth Ministrinë e Drejtësisë. Në mbyllje, ACIPS thekson se Rregullat e Konsultimeve nuk janë gjë tjetër veçse “një letër e vdekur e hedhur në letër”.

mund të limitojë pjesëmarrjen direkte prej qytetarëve, fondacioneve dhe shoqatave në proceset politikbërëse dhe ato vendimmarrëse duke qenë se lobimi përcaktohet shumë gjerësisht duke përfshirë gati çdo aktivitet që synon të influencojë pozicionet e qeverive lokale dhe kombëtare ose Parlamentit ose atë të ndonjë ligji ose akti nënligjor. Pavarësisht kësaj, Ligji nuk aplikohet në praktikë dhe prandaj ka pak efekt praktik në zhvillimin e dialogut.

Mekanizma të kuptueshëm për implementimin e prerogativave ligjore janë vendosur në pak ministri qeveritare dhe departamente të rrajonit dhe **kapaciteti i tyre administrativ** për t'u përfshirë në shoqërinë civile është shpesh në nivel jo të duhur. Pavarësisht kësaj, në mungesë të zgjidhjeve sistematike, ekzistojnë **praktika të mira të përfshirjes së OSHC-ve në hartimin e politikave dhe në konsultim**. Shembujt më të fundit të përfshirjes së OSHC-ve përfshijnë:

- Në **Shqipëri**, Ligji për Ndhimë Ligjore (Dhjetor 2008) i cili vendos prerogativat për një sistem të strukturuar të ndihmës ligjore për aksesin tek drejtësia për njerëzit në nevojë, ishte puna e një projekti të organizuar prej OJQ-së Për Shërbim Ligjor Falas bazuar në Tiranë në bashkëpunim me qeverinë dhe partnerët e shoqërisë civile dhe në mars të vitit 2010 Ligji për Anti Diskriminimin, që u përgatit në konsultim me shoqërinë civile, u miratua nga parlamenti;
- Në **Bosnjë Hercegovinë**, një Strategji e Re Zhvillimi 2008-2013 po hartohet aktualisht paralelisht me një Strategji për Përfshirjen Sociale 2008-2013 dhe shoqëria civile ka qenë aktive në konsultime me punën e koordinuar prej grupeve të punës të përzgjedhura prej Këshillit të OSHC-ve dhe prej Rrjetit të Personave të Moshës së Tretë;
- Në **Kosovë**, një sërë çështjesh që lidhen me pjesëmarrjen e OSHC-ve ose me

ushtrimin e presionit ndaj iniciativave të qeverisë janë vërejtur edhe së fundmi. Pjesëmarrja e një numri të madh OJQ-sh në hartimin e Ligjit për OJQ-të në vitet 200-2009 është një prej rasteve më të mira që tregojnë dialogun civil ndërmjet sektorëve;

- Në **Maqedoni**, OSHC-të kanë qenë shumë të përfshira së fundmi në përgatitjen e Ligjit mbi Shoqatat dhe Fondacionet. Grupi i punës nga Ministri i Drejtësisë ka patur një aktivitet intensiv në vitet 2009 dhe 2010 kur janë mbajtur një sërë takimesh me pjesëtarë aktivë të disa ministrive, organizatave civile dhe ekspertë universitetesh;
- Në fund të vitit 2009, OSHC-të **Malazeze** kanë marrë pjesë aktivisht në hartimin e Ligjit mbi Ndalimin e Diskriminimit, i cili u përgatit nga Ministria e të Drejtave të Njeriut dhe të Minoriteteve me përfshirjen e gjerë të sektorit të OSHC-ve në të gjitha debatet publike, tavolinat e rumbullakëta dhe aktivitetet e tjera që i përkasin këtij ligji;
- Në **Serbi**, ku OSHC-të janë konsultuar me raste në hartimin e legjislacionit sidomos në fusha si psh mbrojtja sociale ose politikat sociale, një shembull i fundit është rasti i Ligjit për Rehabilitimin Profesional dhe Punësimin e Personave me Aftësi të Kufizuar, të cilat përfshinë një numër të lartë OSHC-sh që merren me këtë çështje.

Praktika në tre **VAR**-të është ilustruese dhe e **avancuar** dhe është **ndikuar kryesisht prej kërkesave që burojnë nga Acquis i BE-së, sidomos në fushën e forcimit të kapaciteteve administrative dhe në monitorimin e implementimit**. Në **Bullgari**, OSCH-të kanë propozuar amendamente për *Ligjin e Akteve Ligjore* që propozon një kuadër të qartë rregullash për konsultim me palët e interesuara në fazën e hartimit dhe për shtimin e eësimin të impaktit. Në **Rumani**, gjithashtu një sërë OSHC-sh që merren me mbrojtjen (Shoqata

ProDemocracy, CeRe, FDSC, Advocacy Academy dhe CENTRAS) kanë advokuar gjatë vitit 2007 për vendosjen e dëgjimeve publike për të shtuar transparencën e proceseve Parlamentare. Si rrjedhojë e kësaj iniciative, të gjitha projekt ligjet duhen shoqëruar tashmë nga një vlerësim i impaktit rregullator që hartohet në mënyrë gjithëpërfshirëse prej të gjithë aktorëve kryesorë të përfshirë. Në **Slloveni**, *Qendra për Informacion, Bashkëpunim dhe Zhvillim të OJQ-ve* (CNVOS) hartoi në vitin 2002 e *Procedurën për Zgjedhjen e Përfaqësuesve të OJQ-ve* në struktura të ndryshme të përfshira në politikbërje dhe vendimarrje. Qëllimi i procedurës së përzgjedhjes është që t'ju ofrojë të gjithë individëve dhe organizatave të interesuara një procedurë të unifikuar me rregulla të qarta dhe detyruese për të gjithë ata që përfshihen dhe e cila vepron në përputhje me principet e të qenit e hapur, mundësive të barabarta dhe transparencës. Deri tani 16 procedura të tilla jand ndërmarë për nevojat e Ministrive të ndryshme dhe të Zyrës së Qeverisë për Punët Evropiane. Së fundmi rregullat detyruese për konsultimin publik sipas Rregullave të *Procedurës Qeveritare miratuar* në mars të vitit 2006 dhe një *Rezolutë mbi Aktivitetet Normative* që u miratua në nëntor të vitit 2009 dhe që garanton standardet për konsultimin me publikun kanë vendosur bazat ligjore më të forta për përfshirjen e OSHC-ve por gjithësesi praktika mbete testimi kryesor i partneritetit.

4.4. Përfundimet

Ndërsa sot ne mund të jemi dëshmitarë të ekzistencës të kuadrit të dokumentave shtetërore që rregullojnë dialogun civil në shumicën e vendeve të Ballkanit Peëndimor, sfidat mbeten ende sa i përket **implementimit të plotë të tyre**. Ne kemi parë veçanërisht një progres të konsiderueshëm përsa i përket zhvillimit të mekanizmave gjatë dy viteve të fundit. Implementimi pengohet prej **mungesës së**

vullnetit politik dhe të prioritizimit të fortë të pjesëmarrjes së shoqërisë civile në nivelin kryesor. Prioritizimi i KE-së në Strategjinë e Zgjerimit prej 2007-2008 dhe alokimi i fondeve të IPA-s si edhe financimi prej donatoëve të tjerë ka ndihmuar në kryerjen e këtyre lëvizjeve, por megjithatë pronësia e qeverisë ndaj procesit shpesh herë mungon.

Në mënyrë të njëjtë me këtë, në **nivele më të ulëta administrative dhe vepruese** mungesa e njohurisë rreth sektorit në administratë si dhe mungesa e kapaciteteve të tyre në mundësimin dhe implementimi e strategjive, rregullave dhe marrëveshjeve të miratuara mbetet e lartë. Kapacitetet institucionale të qeverisë për përfshirjen e OSHC-ve janë shpesh të papërputhshme me kapacitetet e krahasueshme të OSHC-ve sa i perket stafit profesionist ose aftësive për lobim, që të përfshihen në bashkëpunim me qeverinë, kështuqë ata shpesh nuk janë të aftë t'u përgjigjen ftesave për pjesëmarrje në proceset konsultative të nisura prej Qeverisë, ose për të zhvilluar një partneritet më serioz me institucionet qeveritare. Megjithatë, edhe pse kanë motivimin dhe ekspertizen, **OSHC-të** duhet që gjithashtu të ndërtojnë incentiva dhe kapacitete për tju përgjigjur organizuar dhe monitoruar masa ligjore specifiek për konsultim në procesin politikbëës.

Një nga testet kryesore mbetet zhvillimi i akteve dhe rregllave (akte nënligjore) specifike që **lejojnë pjesëmarrjen e detyruar** të OJF-ve në politikë dhe vendimarrje (si p.sh në Slloveni). Gjithashtu e drejta për iniciativa politike dhe legjislativë është një hap i paë i ëndësishëm sidomos duke patur parasysh Nenin 11 të Traktatit të Lisbonës dhe debatin që zhvillohet mbi të. Pra, ndërsa hapi i paë tashmë është bënë me përcaktimin e strategjive dhe marrëveshjeve dhe me anë të tyre për përcaktimin e rolit të përgjithshëm në politikbërje të OSHC-ve nevojitet të ndërmerren një sërë masash **ligjore e më së shumti praktike**.

Gjithashtu janë identifikuar një sërë boshllëqesh të përbashkëta sa i përket bashkëpunimit në nivel vendor. Procedurat e zhvilluara dhe të organizuara bashkëpunim ndërmjet OSHC-ve dhe autoriteteve lokale janë të rralla. Niveli i bashkëpunimit varion nga një bashki në tjetën. Bashkëpunimi bazohet kryesisht në përpjekje afatshkurtra dhe në vartësitë e kuptimit prej përfaqësuesve lokalë. Në terma të përgjithshme, megjithatë, edhe pse mekanizmat dhe praktika janë ende të pakta, niveli i përfshirjes së OSHC-ve në nivel lokal shpesh gjykohet si më i favorshëm krahasuar me atë në nivel kombëtar.

5. Integrimi në BE dhe Dialogu Civil

5.1. Politika e Zgjerimit

Në Strategjinë e Zgjerimit 2007-2008, KE e ktheu dialogun civil, krahas zhvillimit të shoqërisë civile në një prioritet kryesor të reformave të anëtarësimit të vendeve të Ballkanit Perëndimor. Zhvillimi i shoqërisë civile dhe dialogu civil do të mund të shndërroheshin për herë të parë një nga prioritetet kryesore të reformave të politikës së Zgjerimit të BE. Kjo etapë ka qenë prej kohësh pjesë e kriterit Politik të Kopenhagenit.

Megjithatë ky zhvillim nuk ndodhi menjëherë. Përjasja u zhvillua në terma të gjeografisë dhe kufijve të veprimit. Ai u adresua fillimisht në qershor 2005 duke targetuar Turqinë dhe Kroacinë përmes *Komunikimit*¹² të Komisionit për të promovuar forcimin e dialogut të shoqërisë civile, që u shtri më pas në janar të 2006 në të gjithë Ballkanin Perëndimor.

Duket (duke qenë se nuk ka arsye eksplicite të përmendura në dokumentet) se kjo etapë u paraqit si pasojë e dy **faktorëve të jashtëm**. Së pari ishte presioni i gjetjes së një “zgjidhje të shpejtë” të “Jo-së” së referendumeve Hollandeze dhe Franceze në kundërshtim të Traktatit të Kushtetutës së BE. Faktori i dytë ishin leksionet negative të mësuara nga fazat e mëparshme të zgjerimit (veçanërisht në Rumani dhe Bullgari), ku për shembull, shumë OSHC u përballën me një ndryshim të menjëhershëm të kushteve vepruese.

Përveç kësaj, edhe një **faktor i brendshëm i zgjerimit** ka luajtur një rol. Progresi i matur në procesin e anëtarësimit në Ballkanin Perëndimor përmes Proges-Raportit shkon përtej monitorimit të thjeshtë të legjislacionit që është miratuar dhe fokusohet fillimisht mbi zbatimin efikas dhe të qëndrueshëm të këtij legjislacioni. Në kriterin politik, janë thelbësore për tu përmbushur, jo vetëm miratimi i legjislacionit, por edhe *funksionimi* i institucioneve demokratike, dhe proceseve të vendim-marrjes. Ashtu si në disa vende jo anëtare të BE-së, KE ka vërejtur zbatim të ngadaltë dhe pak efikas krahasuar me nivelet e dëshiruara. Kështu, dhënia e përparësisë së shoqërisë civile është parë si një rrugë për ta shtyrë këtë gjë më tej.

Objektivi ishte për të mbështetur komunikimin më të mirë të proceseve të zgjerimit dhe mirëkuptimin e përbashkët ndërmjet VA (vendeve anëtare) dhe shoqërive të vendeve candidate, por gjithashtu edhe të forcohej roli i shoqërisë civile në procesin e demokratizimit dhe bashkërendimit. Nuk ka një përkufizim të qartë se çfarë është dialogu (i shoqërisë) civile, ashtu si edhe për Strategjinë e Zgjerimit, në përputhje me objektivat e theksuara.

Në përputhje me Strategjinë e 2007-2008, ka 4 **arsye** kryesore që duhet të kenë

12 COM (2005) 290, 29 Qershor, 2005.

përparësi për zhvillimin e shoqërisë dhe dialogun e shoqërisë civile:

- Forcimi i mbështetjes për reformat;
- Forcimi i demokracisë dhe funksionimit të institucioneve demokratike;
- Masa e lodhjes kundër-zgjerimit; dhe;
- Sigurimi i mbështetjes publike për zgjerimin.

Prandaj, në terma të **përcaktimit dhe asaj që vlerëson ky udhërrëfyes**, udhërrëfyesi i dialogut të shoqërisë civile vlerëson zakonisht:

- Ekzistencën e mekanizmit të dialogut me fokus mbi qeverinë;
- Informacionin dhe transparencën financiare;

ndërsa udhërrëfyesi i zhvillimit të shoqërisë civile vlerëson:

- Mjedisin (ligjor dhe financiar) në të cilin vepron një OSHC në një vend;
- Kapacitetet e OSHC-ve, veçanërisht advokimin;
- Rrjetëzimin (p.sh. Shqipëria).

Nëse vlerësimet e zhvillimit të shoqërisë civile i korrespondojnë matjes së “performancës” së shoqërisë civile në terma të forcimit të reformave dhe funksionimit të institucioneve demokratike, dialogu i shoqërisë civile nuk fokusohet thjesht në përmirësimin e bashkëpunimit dhe shkëmbimit për çështjet e zgjerimit, d.m.th në atë që përcaktohet në strategji, por mbi të gjitha mbi atë që përfaqëson realisht ajo që **përkufizohet gjerësisht si dialogu civil**, d.m.th marrëdhëniet ndërmjet shoqërisë civile dhe institucioneve publike, veçanërisht me qeverinë. Është e qartë se garantimi i mbështetjes publike për zgjerimin dhe masat e lodhjes kundër-zgjerimit (në mënyrë të drejtë) janë zhdukur ose janë bërë më tepër një çështje horizontale dhe rajonale, pra duke mos u adresuar nga vlerësimet dhe udhërrëfyesit për vendet individuale.

Ndërsa udhërrëfyesit u përcaktuan fillimisht si pjesë e prioriteteve rajonale, ato u reflektuan gjithnjë e më tepër në **udhërrëfyesit dhe vlerësimet individuale të vendeve** në Progres-Raportet. Para vitit 2007, vetëm Serbia kishte një udhërrëfyes specifik. Udhërrëfyesit për Maqedoninë dhe Kosovën u paraqitën në 2007, dhe për Shqipërinë në 2008.¹³ Duhet theksuar se Kroacia, Bosnje-Hercegovina dhe Mali i Zi nuk kanë udhërrëfyes specifik që lidhen me zhvillimin e shoqërisë civile dhe dialogun e shoqërisë civile.

Në Partneritetet Evropiane për Anëtarësim, në të cilat përcaktohen treguesit që duhen arritur me qëllim që një vend të bëjë progres në rrugën e tij për anëtarësim në BE, nuk janë freskuar që nga shkurti i 2008 (ndërsa për Malin e Zi që nga janari 2007), prandaj nuk janë paraqitur etapa të tjera konkrete. Megjithatë, duke shqyrtuar pasojat e Progres-Raporteve për vendet individuale të sipër përmendura, **zhvillimi dhe funksionimi i dialogut civil dhe në disa raste financimi shtetëror i OSHC-ve është kthyer në fokusin kryesor të monitorimit të progresit të Komisionit**. Të gjitha vendet, përveç Kroacisë, kanë komentet e tyre në lidhje me këtë çështje. Gjithashtu, theksi vendoset mbi zbatimin e masave të marra ose të partneriteteve serioze në angazhim me shoqërinë civile (p.sh. Mali i Zi). Tabelat e mëposhtme theksojnë faza specifike të progresin në këtë fushë për çdo vend.

Duke parë zhvillimin më të fundit në dialogun civil mbi këtë fushë, mund të thuhet se prezantimi i udhërrëfyesve të BE, proces ky që u zhvillua në periudhën e zhvillimit intensiv, përkon dhe për pasojë ka pasur në disa vende **efekt pozitiv** veçanërisht mbi zhvillimin e dokumenteve kuadër të shtetit. Megjithatë, ky ndikim ende **nuk është strategjik ose koherent në këto vende**. Nëse krahasojmë Progres-

¹³ Shiqo Tabelën 1, fq. 23-24.

Raportet nga 2006 me Progres-Raportet e 2007, 2008, dhe 2009, prioritetet e reja nuk përkthehen ende në terma të zbatimit të barabartë të prioriteteve/udhërrëfyesve dhe të një shqyrtimi më të mëtejshëm më të vëmendshëm mbi udhërrëfyesit në nivel shteti. P.sh. në vendet ku është krijuar së fundmi mekanizmi i dialogut të shoqërisë civile (Maqedonia, Mali i Zi, Bosnje-Hercegovina) ato shërbejnë si fokus i raporteve (edhe përmes financimit nga KE). Megjithatë, në Kosovë dhe Serbi mungojnë ende mekanizmat dhe ata përmenden shumë pak në këto raporte. Vlerësimet përpara dhe pas vendosjes së prioriteteve nuk janë as të gjata, dhe as nuk është përdorur një gjuhë e ashpër, edhe pse në asnjë vend nuk është bërë progres real dhe domethënës.

Fjalët “zhurmuese” të Strategjisë së fundit të Zgjerimit 2009-2010 ishin nevoja për tu fokusuar mbi fusha të vështira për reformat e afërta mbi realizimin e sundimit të ligjit, masat anti-korrupsion dhe lirinë e shprehjes, bazuar mbi leksionet negative të mësuara nga Bullgaria dhe Rumania. Mbi të gjitha, strategjia theksoi se “vendet që janë në procesin e zgjerimit duhet të sigurohen se legjislacioni i ri është përgatitur plotësisht, në përputhje me konsultimet e nevojshme me grupet e interesit, dhe është zbatuar ashtu siç duhet.”¹⁴ Ndërkohë, në Strategjinë e Zgjerimit 2008-2009 dhe 2009-2010 theksohet zhvillimi i shoqërisë civile, ndërsa është riafirmuar shumë pak nga dialogu civil (vetëm) si masa që “forcojnë cilësinë e demokracisë dhe kontribuojnë në bashkërendimin.”¹⁵

Ashtu siç është treguar në kapitullin 3, zbatimi i dokumenteve kuadër të shteteve, por veçanërisht zhvillimi dhe zbatimi i udhëzimeve specifike dhe zbatimi i tyre mbi të drejtën e informimit dhe standardeve minimale për konsultim duket se janë testi kryesor për partneritetet reale me

shoqërinë civile, dhe nëse analizohet me vëmendje, gjithashtu edhe **si një masë politike horizontale e lidhur direkt me reformën në administratë, masat anti-korrupsion dhe sundimin e ligjit, d.m.th të gjitha fushat kryesore të Acquis të BE.** Kështu, nëse Komisioni përcakton “bizneset”, dialogu civil duhet të vendosen si prioritet ashtu si edhe masat e tjera kryesore të *Acquis* të BE, d.m.th që ato të realizohen mundësisht duke u bërë në vetvete **një fushë e Acquis të BE.** Së fundi, **asistenca e IPA** duhet të përdoret **në mënyrë koherente dhe strategjike** në financimin e masave themelore të dialogut civil, veçanërisht e atyre të zotëruara dhe të drejtuara nga shoqëria civile vendore.

Në terma të **monitorimit të mëtejshëm të progresit në proceset e anëtarësimit,** fokusi duhet të jetë mbi **zbatimin e strukturave shtetërore ose masave të tyre të zhvillimit nëse nuk ekzistojnë** në terma të **hapjes dhe angazhimit të qeverisë në këtë proces.** Për më tepër, **roli i vendosur në koordinimin e mekanizmit dhe krijimit të strukturave të përbashkëta qeveri-OSHC** duhet të matet në terma të **kapacitetit administrativ dhe transparencës së institucioneve.** Së fundi por më e rëndësishmja, **miratimi dhe zbatimi i plotë i akteve të caktuara ligjore (urdhëresave) për standardet minimale për aksesin ndaj informacionit dhe konsultimin e politikë-bërësve dhe vendim-marrësve** duhet të bëhet e **detyrueshme dhe të ndiqet në Progres-Raportet** si testi kryesor për detyrimin e qeverisë për të qenë **e ndershme, e hapur dhe e barabartë në partneritete.**

¹⁴ COM (2009) 533, 14 Tetor, 2009, fq. 8.

¹⁵ Ibid.

Tabela 1: Dialogu Civil BE dhe etapat dhe vlerësimet e (zhvillimit të shoqërisë civile) 2007-2010

Vendi	2006-2007	2007-2008	2008-2009	2009-2010 ¹⁶
Shqipëria	N/A	N/A	Inkurajimi i pjesëmarrjes aktive të OJQ-ve dhe të OSHC-ve të tjera në procesin vendim-marrës të qeverisë dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së gazetarisë.	Pjesëmarrja e OSHC-ve në vendim-marrje kërkon forcim të mëtejshëm.
Bosnje- Hercegovina	N/A	N/A	N/A	Nevojat ekzekutive për të bërë përpjekje të mëtejshme për të rritur dialogun me sektorin e shoqërisë civile dhe për të mbështetur zhvillimin e tij. Autoritetet duhet të sigurojnë që shpërndarja e fondeve tek OJQ-të bëhet sipas një mënyre objektive dhe transparente.
Kroacia	N/A	N/A	N/A	N/A
Kosova	N/A	Miratimi i legjislacionit mbi shoqatat dhe statusin ligjor të OJQ-ve, inkurajimi i zhvillimit të OSHC-ve dhe dialogut të rregullt me shoqërinë civile mbi iniciativat politike.	Miratimi i legjislacionit mbi shoqatat dhe statusin ligjor të OJQ-ve, inkurajimi i zhvillimit të OJQ-ve dhe dialogut të rregullt me shoqërinë civile mbi iniciativat politike. Zbatimi i ligjit të anti-diskriminimit në mënyrë efektive. Në veçanti, krijimi i zyrave plotësisht operacionale të të drejtave të njeriut brenda ministrive, dhe sigurimi i pavarësisë së tyre dhe koordinimit me aktivitetin e Avokatit të Popullit. Organizimi i fushatave të ndërgjegjësimit për të informuar sektorin privat, shoqërinë civile dhe qarqet akademike mbi këtë ligj. Monitorimi i zbatimit të ligjit dhe raportimit mbi të. Vazhdimi i përpjekjeve për të rritur ndërgjegjësimin publik dhe pjesëmarrjen e shoqërisë civile në çështjet mjedisore. Zhvillimi i planeve të veprimit sektorial për të luftuar korrupsionin dhe për të rritur ndërgjegjësimin mbi problemin e korrupsionit në administratën publike po ashtu edhe në shoqërinë civile.	Shoqëria civile duhet të jetë e integruar më mirë në formulimin dhe zbatimin e politikave.

16 Nuk ka pasur të dhëna të fundit mbi partneritetet e Pranimit/Evropiane që nga shkurti 2008 (përveç Malit të Zi që nga janari 2007). Masat/etapat e kërkuara janë pjesë e Progres-Raportit 2009.

Vendi	2006-2007	2007-2008	2008-2009	2009-2010 ¹⁶
Maqedonia	N/A	Zbatimi në mënyrë efektive i masave të miratuara për të siguruar transparencë në administratë, në veçanti në procesin e vendim-marrjes, dhe për të promovuar më tej pjesëmarrjen aktive të shoqërisë civile.	Zbatimi në mënyrë efektive i masave të miratuara për të siguruar transparencën në administratë, në veçanti në procesin vendim-marrës, dhe për të promovuar më tej pjesëmarrjen aktive të shoqërisë civile.	<p>Është i nevojshëm progresi në zbatimin e strategjisë dhe plan-veprimit të qeverisë për bashkëpunimin me OSHC-të dhe Ligjin mbi Sponsorizimet dhe Donacionet.</p> <p>Respektimi i mekanizmave ekzistues të konsultimit nga qeveria dhe angazhimi i plotë në një dialog domethënës me shoqërinë civile. Hartimi i draft-ligjit dhe vlerësimeve rregullatore si forma të vlefshme për rishikim nga publiku i gjerë.</p> <p>Ekziston një nevojë për mekanizma transparentë dhe sistematikë për konsultimin e shoqërisë civile mbi zhvillimin e politikave kombëtare, legjisacionin, programet ose dokumente të tjerë strategjikë.</p>
Mali i Zi	N/A	N/A	N/A	Qeveria duhet të punojë në mënyrë konstruktive me përfaqësuesit e shoqërisë civile.
Serbia	Inkurajimi i zhvillimit të OSHC-ve financiarisht dhe veçanërisht përmes miratimit të ligjit mbi shoqatat, dhe ligjit mbi statusin ligjor të OJQ-ve të huaja. Zbatimi dhe mbështetja e aktiviteteve për të rritur ndërgjegjësimin publik dhe pjesëmarrjen e shoqërisë civile në çështjet e mjedisit.	Miratimi i ligjit mbi shoqatat dhe statusin ligjor të OJQ-ve, inkurajimi i zhvillimit të OSHC-ve dhe dialogut të rregullt me shoqërinë civile mbi iniciativat e politikave.	<p>Miratimi i ligjit mbi shoqatat dhe statusin ligjor të OJQ-ve, inkurajimi i zhvillimit të rregullt me shoqërinë civile mbi iniciativat e politikave.</p> <p>Zbatimi i ligjit të anti-diskriminimit në mënyrë efektive. Në veçanti, krijimi i zyrave plotësisht operacionale të drejtave të njeriut brenda ministrive, dhe sigurimi i pavarësisë dhe koordinimit aktivitetet e Avokatit të Popullit.</p> <p>Organizimi i fushatave ndërgjegjësuere për të informuar sektorin privat, shoqërinë civile dhe qarqet akademike mbi këtë ligj. Monitorimi i zbatimit të ligjit dhe raportimi mbi të.</p> <p>Vazhdimi i përpjekjeve për të rritur ndërgjegjësimin publik dhe pjesëmarrjen e shoqërisë civile në çështjet e mjedisit.</p> <p>Zhvillimi i planeve sektoriale të veprimit për të luftuar korrupsionin dhe rritur ndërgjegjësimin për problemin e korrupsionit tek administrate publike po ashtu edhe tek shoqëria civile.</p>	<p>Ka pasur disa përpjekje brenda administratës serbe për të përmirësuar bashkëpunimin me shoqërinë civile, por kjo duhet të zhvillohet më tej.</p>

5.2. Mbështetja me fonde nga BE-ja për Dialogun Qytetar

Sipas Strategjisë së Zgjerimit të 2007-2008, mekanizmi i financimit për të mbështetur zhvillimin e plotë të shoqërisë civile dhe udhërrëfyesit të dialogut civil u prezantua përmes Instrumentit të Shoqërisë Civile (ISHC) nga Këshilli i BE në dhjetor 2008. Synimi i ISHC është i trefishtë: të mbështesë ndërtimin e kapaciteteve dhe rolin e shoqërisë civile, të përfshijë përfaqësuesit e shoqërisë civile në institucionet dhe procedurat e BE, dhe të mbështesë partneritetin ndërmjet shoqërisë civile dhe sektorëve të tjerë po ashtu me homologët në vendet e tjera të rajonit dhe shtetet anëtare. Për herë të parë, duke u kombinuar më këto ide, Rregullatorja e IPA sollti një përgjegjësi në emër të Komisionit dhe vendit përfitues për tu konsultuar me aktorët e shoqërisë civile në menaxhimin, zbatimin dhe vlerësimin e asistencës së IPA (d.m.th të parimit të partneritetit). Kështu, IPA premtoi të sillte mbështetjen *politike, financiare dhe partneritetet* për të mbështetur rolin e sektorit të shoqërisë civile në Ballkanin Perëndimor. Brenda strukturës së ISHC, mbështetja financiare për shoqërinë civile në Ballkanin Perëndimor dhe Turqinë në periudhën 2008-2010 ishte përafërsisht e trefishuar në krahasim me periudhën CARDS (2005-2007), kur Komisioni e mbështeste shoqërinë civile më një shumë 27 milion euro.

Nëse shikohet me vëmendje financimi i veçantë për dialogun civil në rajon, arrihet në përfundimin se Komisioni si një strukturë relativisht e re e sapo ardhur në këtë fushë është larg të qenit aktori i vetëm kryesor. Nën terma të financimit rajonal, si program i shumë-përfitimit, ISHC ka financuar në mënyrë indirekte dialogun civil nën Asistencën Teknike për ndërtimin e kapaciteteve të OJQ-ve në Ballkanin Perëndimor dhe Turqi (e cilësuar tashmë

si projekti TACSO). Megjithatë, thirrja e fundit rajonale për propozime synonte që të mbështeste në mënyrë direkte dialogun civil u lançua në 2008, d.m.th *Mbështetja e Dialogut të Shoqërisë Civile CARDS 2006 – Njerëzit për Veprimin Njerëzor: Konsolidimi i partneriteteve ndërmjet OJQ-ve dhe autoriteteve publike për rritjen e të drejtave të minoritetit në rajon (1,95 milion euro)*. Sipas projekteve kombëtare të ISHC, Shqipëria, Bosnje-Hercegovina, Kroacia dhe Maqedonia janë vendet ku Komisioni ka investuar në zhvillimin e mekanizmave të dialogut civil ose me qeverinë ose në ndërtimin e kapaciteteve të shoqërisë civile për të marrë pjesë në dialogun civil (ose të dyja). Deri tani, mbështetja e Komisionit ka qenë pikënisja e zhvillimit të mekanizmave të dialogut civil vetëm në Maqedoni, ndërsa në vendet e tjera mbështetja është plotësuese ose vazhduese e përpjekjeve të tjera lokale ose të donatorëve. Në disa raste, si në Bosnje-Hercegovinë, mungesa e koordinimit dhe faza e ndërhyrjes së Komisionit kanë një ndikim të kundërt mbi zhvillimin e përpjekjeve të dialogut civil lokal. Ndërsa mund të duket se është ende herët për të gjykuar për rezultatet, aktualisht, Komisioni ka investuar në një mënyrë efektive, në nivelin kombëtar të ISHC në disa vende për të zhvilluar mekanizmin e dialogut civil, por deri tani mungojnë ende rezultate thelbësore. Në Maqedoni, ku Komisioni ka investuar deri tani më tepër në zhvillimin dhe funksionimin e mekanizmit të dialogut civil, ai thekson në Raport-Progressin e fundit 2009-2010 që “është ngadalësuar progresi mbi zbatimin e strategjisë së qeverisë dhe planit të veprimit për bashkëpunimin me organizatat e shoqërisë civile”, në ndërhyrjen që është financuar nga Komisioni nën mbështetjen e CARDS si dhe IPA. Një nga problemet është se investimi në mekanizmin e dialogut civil është varur gjerësisht nga Komisioni dhe financimi qeveritar, ashtu si edhe në rastin e vendeve të tjera. Në Bosnje-Hercegovinë, projekti aktual i KE është duke u investuar si në ndërtimin e kapaciteteve të shoqërisë

Tabela 2: Projektet e Zgjedhura të Dialogut Civil në vendet e Ballkanit Perëndimor

Vendi	Titulli i Projektit	Donatori
Shqipëria	Konsultimi mbi kufirin e buxhetit të Shqipërisë për shoqërinë civile/ Hartimi i Kartës Shqiptare të shoqërisë civile	OSBE
	Forcimi i shoqërisë civile dhe strukturave demokratike	GTZ
Bosnje-Hercegovina	Programi për Partneritet të Pjesëmarrjes Qytetare (PpPQ) Zhvillimi i qëndrueshëm i sektorit jo-fitimprurës në Bosnje- Hercegovinë (CCSP)	USAID
	IPA ndërtimi i kapaciteteve të shoqërisë civile si pjesëmarrëse në dialogun politik	KE
Kroacia	PHARE Lehtësimi i sektorit të shoqërisë civile për kontributin aktiv në procesin e para-aderimit – Skema e grantit në fushën e: demokratizimit dhe të drejtave të njeriut, zhvillimit të qëndrueshëm dhe mbrojtjes së mjedisit, pjesëmarrjes së të rinjve CARDS Skema e Grantit: Qeverisja e mirë dhe sundimi i ligjit CARDS 2004 Grante për organizatat aktive të shoqërisë civile në mjedis dhe zhvillimin e qëndrueshëm dhe shpërndarjen e shërbimeve sociale IPA Zhvillimi i kapaciteteve të OSHC-ve për monitorimin sistematik të Politikave të zhvillimit të qëndrueshëm dhe përfaqeset e integruara për menaxhimin dhe kursimin e ujit, transportin, eficientë energjitike, zhvillimin rajonal, përdorimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore IPA Rritjen e pjesëmarrjes së OSHC-ve në monitorimin e zbatimit të Acquis së BE në fushën e luftës kundër korrupsionit dhe transparencën e përgjithshme, sinqeritetin dhe përgjegjësinë e trupave të administratës publike IPA Rritja e kapaciteteve/roleve të OSHC-ve në monitorimin e zbatimit të Acquis të BE në fushën e Strategjisë gjithëpërfshirëse të anti- diskriminimit	KE
Kosova	N/A	
Maqedonia	CARDS Asistenca teknike për sektorin e shoqërisë civile në qeveri IPA Forcimi i kapacitetit të sekretariatit të përgjithshëm – Sektori i analizës së politikave dhe koordinimit – Sektori për reformën e administratës publike dhe sektori për bashkëpunimin e OJQ-ve.	KE
Mali i Zi	N/A	
Serbia	Iniciativa e Advokimit të shoqërisë civile	USAID
	IPA Forcimi skemës së grantit Serbi-BE të Dialogut të shoqërisë civile përmes asistencës teknike	KE

civile po ashtu edhe në qeveri. Në Shqipëri ndërhyrja ishte vetëm në pjesën e shoqërisë civile, ndërsa në Kroaci është qeveria ajo që ka programuar fondet e KE në konsultim me shoqërinë civile. Në nivelin rajonal, projekti TASC0 ka vetëm një nën-komponent që merret me dialogun civil, d.m.th ndërtimi i kapaciteteve të qeverive në bashkëpunim me OSHC-të, por kjo nuk bazohet as tek fokusi e as tek synimi i ndërhyrjes. Ndërko-

hë në mars 2008, u organizua një workshop në Shkup për të sjellë së bashku zyrtarë ekzistues qeveritarë për bashkëpunim me OSHC-të dhe organe të tjera (nga vendet, ku këto nuk ekzistojnë), si i tillë në interesin e financimit të Komisionit nuk kanë qenë aktivitete sinergjike rajonale, megjithëse dialogu civil është një prioritet i Zgjerimit rajonal. Kështu, duket se financimi i KE për masat e dialogut civil është i shpërndarë dhe

incoherent me udhërrëfyesit, që redukton mundësinë e të qenit efektiv në mbështetjen e përpjekjeve lokale të shoqërisë civile po ashtu edhe në arritjen e etapave të anëtarësimit. Kështu, duket se financimi i KE për masat e dialogut civil **shpërndahet në një mënyrë jokohërente me udhërrëfyesit**, gjë që **redukton mundësinë e të qenit efektiv në mbështetjen e përpjekjeve të shoqërisë civile lokale po ashtu edhe arritjen e etapave të anëtarësimit.**

Kështu, në terma të financimit, KE duhet të koordinojë ngushtë dhe të përdorë në mënyrë strategjike mbështetjen e IPA për të financuar fusha të dialogut civil të identifikuar si të dobëta si:

- Masat e synuara për **zhvillimin dhe zbatimin e dokumenteve dhe mekanizmave të kuadrit shtetëror** ekzistues me **zotërimet vendore**;
- Masat e **ndërtimit të kapaciteteve dhe rritjes së ndërgjegjësimit të mekanizmave koordinues dhe administrimit për zbatimin e vendimeve shtetërore dhe akteve specifike (urdhëresat)**;
- Masat për **ndërtimin e kapaciteteve të OSHC-ve dhe aftësinë e tyre për të filluar advokimin në politikë-bërjen dhe vendim-marrjen**
- **Iniciativat sinergjike për shkëmbimin e praktikave të mira dhe informacionin** ndërmjet vendeve (para)-aderuese po ashtu edhe ato të BE-së.



6.10 Rekomandime për Dialog Civil Efikas në Ballkanin Perëndimor

- Parimet e politikës dhe asistencës së **koherencës, efektivitetit, zotërimit** dhe **qëndrueshmërisë** duhet të jenë parimet udhëheqëse të ndërhyrjeve të BE në dialogun civil në Ballkanin Perëndimor;
- Dialogu civil duhet të kuptohet si një **masë politike horizontale** e lidhur në mënyrë direkte me reformën e administratës publike, masat anti-korrupsion dhe sundimit të ligjit, d.m.th të gjithë fushat kyçe të *Acquis* të BE. Nëse Komisioni citon “biznesin”, dialogu civil duhet të vendoset si një prioritet ashtu si edhe masat e tjera kyçe të *Acquis* të BE ose edhe të bëhet një fushë e *Acquis* në vetvete;
- Monitorimi i progresit duhet të fokusohet njëkohësisht edhe mbi **zbatimin e kuadreve shtetërore** dhe **masave për zhvillimin e tyre** nëse nuk ekzistojnë në terma të transparencës dhe angazhimit të qeverisë në proces. Gjithashtu, progresi duhet të ndjekë në mënyrë specifike miratimin dhe **zbatimin e plotë të akteve specifike ligjore (udhëzimet) për aksesin në informacion dhe standardet e detyrueshme minimale për konsultim** si një test kyç për detyrimin e qeverisë ndaj të qenit e ndershme, e hapur dhe e barabartë në partneritet;
- **Mbështetja e IPA duhet të jetë koherente dhe e lidhur në mënyrë strategjike me plotësimin e udhërrëfyesve, d.m.th sfidat e identifikuar në hapësirën e dialogut civil**, veçanërisht masat e synuara në zhvillimin dhe **zbatimin e dokumenteve dhe mekanizmave të kuadreve shtetërore** ekzistuese me zotërimet vendore, **ndërtimin e kapaciteteve** dhe **rritjen e ndërgjegjësimit të mekanizmave koordinues dhe administrues** për zbatimin e kuadreve shtetërore dhe akteve specifike (urdhëresave), **ndërtimit të kapaciteteve të OSHC-ve** dhe aftësinë e tyre për të iniciuar advokimin në politikë-bërje, dhe vendim-marrje, **iniciativat sinergjike për shkëmbim** të praktikave më të mira dhe informacionit ndërmjet vendeve (para)-aderuese dhe atyre të BE;
- **Qeveritë kombëtare** së bashku me **OSHC-të lokale (veçanërisht platformat/rrjetet)** duhet të kenë zotërimin kryesor mbi zhvillimin e strukturave ose mekanizmave. Qeveritë kombëtare duhet të tregojnë **hapjen, ndershëmërinë dhe partneritetet e përbashkëta** drejt shoqërisë civile;
- **OSHC-të lokale** duhet të forcojnë **bashkëpunimin ndër-sektorial rajonal dhe kombëtar** dhe të koordinojnë iniciativat sektoriale mbi çështje të interesit të përbashkët, veçanërisht në çështjet si dialogu civil në sektorë me interes të përbashkët;
- **Sinergjitë rajonale** ndërmjet qeverive kombëtare në zhvillimin dhe zbatimin e mekanizmave të dialogut civil duhet të identifikohen dhe të lidhen me **forumet e bashkëpunimit ndër-qeveritar rajonal** për të ndarë leksionet e mësuara dhe lehtësuar të mësuarin institucional dhe të barabartë;
- Masat, si **zhvillimi i financiar i qëndrueshëm** i aktorëve të shoqërisë civile përmes mbështetjes së buxhetit shtetëror transparent dhe efektiv dhe mbështetjes efektive dhe transparente të buxhetit të shtetit dhe mbështetjes së zhvillimit të mjedisit lehtësues për korporatat dhe entitetet individuale

duhet të konsiderohet si një **masë indirekte** e rëndësishme në sigurimin e partneriteteve të barabarta të shoqërisë civile në politikë-bërje dhe vendim-marrje;

- Ndërsa procesi i anëtarësimit është i lidhur fillimisht me performancën e qeverisë, dialogu civil duhet të kuptohet dhe kështu të matet në **një sens shumë më të gjerë**, veçanërisht duke përfshirë këtu funksionimin e parlamentit në terma të fillimit të ligjeve të reja dhe bashkëpunimit me OSHC-të;
- Vlera e **qytetarëve dhe kontributi i OSHC-ve** në politikë-bërje dhe në procesin e vendim-marrjes nuk duhet të peshohet në terma të përfaqësimit dhe anëtarësisë, por në cilësinë e **argumenteve dhe zgjidhjeve** që ajo i sjell procesit të politikë-bërjes dhe vendim-marrjes. Roli i OSHC-ve nuk është në përfaqësimin, por në **regullimin dhe në shtimin e vlerës** përmes ekspertizës dhe aksesit të zërave të marginalizuar në shoqëri të rrymës kryesore të procesit të politikë-bërjes dhe vendim-marrjes.

